



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 28. JUNA 2019. GODINE**

**QERSHOR - JUN  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Heqja e monopolit lidhur me shërbimin e homologimit të veturave

## **Dnevni red**

1. Uklanjanje monopola vezano za usluge homologacije vozila

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.**

KRYESUESI: Të nderuar kolegë deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 53 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ne do të procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës për këtë seancë:

### **1. Heqja e monopolit lidhur me shërbimin e homologimit të veturave**

Të nderuar kolegë,

53 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për heqjen e monopolit lidhur me shërbimin e homologimit të veturave.

E ftoj zotin Avdullah Hoti, që në emër të iniciuesit të kësaj seance të paraqesë dhe të arsyetojë çështjen për të cilën është kërkuar mbajtja e seancës.

Domethënë, do t'ia kaloni fjalën deputetit Zharku.

Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku, në emër të iniciuesit të seancës.

LUTFI ZHARKU: Nënkyetar i nderuar,

Kolegë deputetë,

Homologimi, si procedurë përmes së cilës vërtetohet se mjeti i caktuar i përmbush dispozitat përkatëse administrative dhe standardet përkatëse teknike, është i njohur për çdo qytetar të Kosovës sot e 10 vjet.

Fatkeqësisht, nga qytetarët e vendit homologimi nuk njihet për rëndësinë që ka në komunikacionin rrugor, por është sinonim i një biznesi, të cilën e ka shpikur shteti. Dhe më e keqja është se ky nuk është biznes i domosdoshëm, të cilin do ta pranonin me vullnet dhe respekt qytetarët, për shkak se do të ndjeheshin më të sigurt në automjetet e tyre, por biznes i tillë që krijon të ardhura vetëm për një kompani. Kështu, sot e dhjetë vjet më parë, shteti ka krijuar monopol në ofrimin e shërbimit publik.

Gjeneza e homologimit është Marrëveshja e Mirëkuptimit e nënshkruar më 22 shtator 2008 në mes të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe kompanisë “Euro-Lab”, me qëllim të zbatimit të kërkesave ligjore për homologimin e automjeteve, si dhe zbatimit profesional të procedurave teknike sipas standardeve evropiane, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ 2008/08 për homologimin e automjeteve dhe për implementimin e Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor.

Marrëveshja është shumë e shkurtër, madje as nene nuk ka, por që bazohet në dy çështje. Në njërin anë, “Euro-Lab” obligohet të investojë dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet teknike, ku përfshihen pajisjet teknike, sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe stafit profesional të kualifikuar dhe trajnuar sipas standardeve të BE-së. Në anën tjetër, ministria i ka dhënë “Euro-Labit” të drejtën ekskluzive në Republikën e Kosovës që të kryejë të gjitha shërbimet e homologimit.

Në përputhje me këtë marrëveshje, “Euro-Labi” ka kryer investimet e duhura të cilat janë konfirmuar nga komisioni i ministrisë i formuar për këtë qëllim, i cili edhe i ka propozuar ministrit që të lëshojë autorizimin.

Përderisa marrëveshja nuk përcakton afatin e vlefshmërisë, kjo çështje është përcaktuar me autorizimin e lëshuar me vlefshmëri 10-vjeçare, gjegjësisht nga 1 korriku 2009 deri më 1 korrik 2019. Për më tepër, autorizimi është zgjeruar edhe me shërbimin e “mbikëqyrjes profesionale të kontrolleve teknike” që nuk ka qenë e përfshirë në Marrëveshjen e Mirëkuptimit, por që ka qenë e paraparë me nenin 14 të Udhëzimit 2008/08, që institucioni i autorizuar për homologim kryen edhe mbikëqyrjen profesionale të kontrolleve teknike.

Duke marrë parasysh që kemi të bëjmë me ofrimin e shërbimit publik, i cili do të ofrohet vetëm nga një kompani, ministrat e transportit dhe financave të asaj kohe kanë marrë vendim mbi caktimin e çmimeve për shërbimet e homologimit, ku për vetura, motoçikleta dhe rimorkio deri në 3.5 tonë, është përcaktuar çmimi prej 100 eurove, për rimorkio mbi 3.5 tonë është çmimi 150 euro dhe për autobus dhe kamion është 200 euro, përfshirë TVSH-në, të cilat janë valide edhe sot.

Gjatë kohës sa kam udhëhequr me atë ministri, nuk më është ofruar asnjë vlerësim apo analizë se si janë përcaktuar këto çmime. Përndryshe, Udhëzimi 2008/08 për homologimin e automjeteve me nenin 13 ka paraparë autorizimin e vetëm një institucioni për homologimin e automjeteve, kurse para nënshkrimit të kontratës dhe dhënies së autorizimit, ministria nuk ka shpallur procedura të tenderimit, duke shmangur në këtë formë konkurrencën dhe duke i dhënë qasje ekskluzive vetëm një kompanie. Në aspektin financiar, të dyja këto shërbime, homologimi dhe mbikëqyrja profesionale e kontrolleve teknike, aktualisht arrijnë shumën prej 3.5 deri 4 milionë euro në vit që paguhen nga qytetarët tanë.

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja e cila i ofron ekskluzivitet në ofrimin e shërbimeve të homologimit me autorizimin 10-vjeçar, secilës qeveri pasuese ia ka bërë të pamundur ndryshimin e kësaj situatë përmes ndërmarrjes së çfarëdo akti të njëanshëm. Duke marrë parasysh këtë gjendje, Qeveria e Kosovës mori vendimin nr. 17/44, më 12.08.2015, për fillimin e procedurave për eliminimin e të gjitha veprimeve që kufizojnë konkurrencën e lirë ose praktikave që kufizojnë konkurrencën, si dhe ato të cilat krijojnë detyrime për qytetarët, e të cilat nuk janë parapare me ligjet në fuqi. Në përputhje

me këtë, gjatë Qeverisë së kaluar jemi përpjekur që në mënyrë miqësore dhe në frymën e bashkëpunimit të amendamenteve Marrëveshjen e Mirëkuptimit duke hequr “të drejtën ekskluzive” me qëllim të hapjes rrugë të autorizimit edhe të subjekteve të tjera për ofrimin e këtij shërbimi, duke dërguar shkresë zyrtare “Euro-Labit” më 6 janar 2016. Në përgjigjen e tyre, “Euro-Lab” ka refuzuar ndryshimin e marrëveshjes, duke u thirrur në investimet e mëdha të bëra në ndërtimin e kapaciteteve infrastrukturore, teknike dhe teknologjike, si dhe burimeve njerëzore dhe se çdo ndryshim i kësaj klauzole do të dëmtonte atë, dhe se monopolet në këtë fushë ekzistojnë edhe në vendet e BE-së.

Natyrisht që është analizuar edhe opsioni i njëanshëm i liberalizimit të tregut apo edhe ndërprerjes së ofrimit të shërbimit të homologimit, por që të gjitha rekomandimet nga juristë, brenda dhe jashtë ministrisë, kanë qenë se veprimet e tilla do të mund të kenë pasoja financiare për Qeverinë, në rast të hapjes së procesit gjyqësor, duke marrë parasysh klauzolën e ekskluzivitetit që përmban marrëveshja. Kështu, në rast të humbjes së procesit gjyqësor, kompania përsëri do të merrte paratë pa ofruar shërbimin e përcaktuar me marrëveshje nga buxheti i Republikës së Kosovës, dhe jo nga qytetarët. Prandaj, është zgjedhur opsioni i respektimit të marrëveshjes dhe autorizimit të dhënë në njëerën anë dhe përgatitja e infrastrukturës së re ligjore që mundëson liberalizimin e tregut pas skadimit të afatit të autorizimit, e që është trupëzuar në Ligjin nr. 05/L-132 për automjete, i miratuar më 18 prill 2017, që është edhe sot në fuqi.

Deputetë të nderuar,

Këto ditë nga ministri Lekaj kam dëgjuar se fajtor është Ligji për automjete, të cilit i është vazhduar monopoli aktual në këtë fushë. Janë për keqardhje këto deklarata dhe arsyetime banale. Është e pakuptueshme se si mundet një ministër që gati pas dy vjetëve në pushtet të ankohet për infrastrukturë ligjore. Kjo veç dëshmon se Qeveria nuk ka politika të saj dhe e konfirmon se ligji në fuqi i miratuar nga Ju deputetë, i sponsoruar nga unë si pjesë e Qeverisë së kaluar, është aq i mirë sa që nuk kanë guxim as ta prekin. Ne nuk e mendojmë të drejtën e Qeverisë dhe as të subjekteve politike që e përbëjnë që në politikat e tyre ekonomike të favorizojnë monopolet për ofrimin e shërbimeve të caktuara publike. Megjithatë, Qeveria, politikat e tilla duhet t’i trupëzojë paraprakisht në ligje, të cilat duhet t’i aprovojë Kuvendi, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. Prandaj, unë pres që ministri të dalë e të mbrojë politikën e Qeverisë për vazhdimin e monopolit, përmes Udhëzimit administrativ 2/2018, të para më shumë se një viti, e jo të thirret në dispozita, të cilat lidhje nuk kanë me këtë çështje, e që çdo qytetar mundet lehtë ta vërtetojë. Nëse mendojnë ndryshe, duhet ta kishin ndryshuar ligjin. Për këtë arsye, më duhet të konfirmoj se Ligji për automjete që është në fuqi në secilën dispozitë të tij jo vetëm që krijon kushte, por obligon liberalizimin e plotë në fushën e ofrimit të shërbimeve të homologimit. Në mënyrë që të mos lihen dilema për këtë çështje, në tërë ligjin i është dhënë kujdes edhe gjuhës së përdorur, ku pothuajse në tërë tekstin flitet në shumës për subjektet e autorizuara për homologim, e jo në njëjës.

Më lejoni të përmend dispozitat kyçe, të cilat dëshmojnë frymën e ligjit për liberalizim të kësaj fushe. Kështu, neni 10.2 në mënyrë të saktë përcakton se “procedurën për homologimin e mjetit rrugor e kryejnë subjektet e autorizuar për homologim nga ministria”, kurse neni 10.3 thotë se ministria me akt nënligjor do të përcaktojë kushtet dhe kriteret të cilat duhet t’i përmbushin subjektet e autorizuar për homologim”. Neni 15 për procedurë të homologimit përcakton se “prodhuesi, përfaqësuesi i prodhuesit apo pronari i mjetit duhet të paraqesë kërkesë të veçantë (ndaras) pranë ndonjërit prej subjekteve të autorizuar për homologim”. Neni 16 me vetë titullin flet për “obligimet e subjekteve të autorizuar për homologim”, kurse neni 33 ka titullin “Funksionet e subjekteve për homologim”, duke vazhduar me “Subjektet e autorizuar për homologim që kryejnë punët si vijon:”. Neni 34.1 përcakton kushtet funksionale dhe operative për “subjektet e autorizuar për homologim”.

Më duhet të sqaroj se neni 34.2, të cilin ministri Lekaj u mundua ta keqinterpretonte në mënyrën më të vrazhdë për të arsyetuar vazhdimin e autorizimit aktual, i cili në fakt rregullon afatin e vlefshmërisë së licencës së cilitdo subjekt të autorizuar për homologim që i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 34.1. Neni 35.3 përcakton se “përcjellja dhe mbikëqyrja ndaj subjekteve të autorizuar për homologim ushtrohet nga Ministria”. Po ashtu neni 36 flet për plotësimin e pandërprerë të kushteve të subjekteve të autorizuar për homologim. Njësoj, neni 38 autorizon ministrin që me akt nënligjor të përcaktojë kushtet për autorizim të subjekteve. Se ligji për automjete në fuqi obligon liberalizimin e tregut dëshmon edhe neni 88.2, sipas të cilit “subjektet për kontrollë teknike mund të licencohen edhe për homologim të mjeteve sipas kushteve të parapara”. Se ligji për automjete në fuqi është në përputhje të Direktivës 2007/46/EC të BE-së, e konfirmon edhe Grant Thornton në analizën e praktikave më të mira të homologimit të hartuar në nëntor, 2018. Kjo dëshmon se nuk është problem ligji për automjete, por politikat qeveritare, të cilat prodhojnë akte nënligjore në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Të nderuar kolegë,

I përmendëm të gjitha këto dispozita për të dëshmuar se pikërisht dispozitat e caktuara të Udhëzimit administrativ 2/2018, për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore të datës 12 prill 2018, i nënshkruar nga ministri Lekaj, janë në kundërshtim me Ligjin për automjete në fuqi. Kështu, neni 7 i këtij udhëzimi, i cili përcakton parakushtet për autorizim kufizon hyrjen e subjekteve të reja në këtë fushë, duke kushtëzuar që subjekti aktual i autorizuar të shfrytëzojë kapacitetet e tij në shkallë arbitrare prej 85% dhe bazuar në studim të fizibilitetit.

Me asnjë nen, Ligji për automjete në fuqi nuk i jep të drejtë ministrit që të kufizojë hyrjen e subjekteve të reja në këtë treg, duke krijuar kushte për vazhdimin e monopolit në këtë fushë. E drejta e tij është vetëm të përcaktojë kushtet që duhet t’i plotësojnë subjektet për t’u autorizuar për homologim. Kjo dispozitë, përpos që është në kundërshtim me Ligjin për automjete, është kundërshtuar edhe nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili me mendimin profesional të datës 22

dhjetor 2017 vëren se nenet 3.2, 6, 7, 20.2 dhe 20.3 bien ndesh me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës dhe i ka rekomanduar Ministrisë së Infrastrukturës që ta bëjë plotësimin dhe ndryshimin e këtyre dispozitave deri sa udhëzimi ishte në fazën e draftit, si dhe ka sugjeruar liberalizimin e tregut të homologimit të automjeteve.

Po ashtu, edhe Zyra e BE-së në Kosovë më 13 mars 2018, me shkresë zyrtare ka njoftuar ministrin Lekaj se dispozitat e trupëzuara në draft-udhëzimin administrativ cenojnë ligjin e konkurrencës në Kosovë dhe në BE, duke shtuar se drafti i tillë do të abuzonte edhe më tutje monopolin ekzistues. Për më tepër, homologimi i veturave të reja paraqet barrierë jotarifore, që është në kundërshtim me principet themelore të MSA-së.

Duke marrë parasysh që ministri Lekaj shpërfilli vërejtjet në draft-udhëzim, BE bregat e njëjta i përsëriti edhe në shkresën e datës 9 korrik 2018, duke shtuar se bartësi i monopolit ekzistues është konsultuar dhe përfshirë në hartimin e Udhëzimit administrativ, kështu duke theksuar rëndësinë e evitimit të konfliktit të interesit. BE për këtë qëllim angazhoi edhe ekspertë të jashtëm, të cilët me raportin e tyre konfirmuan se ekziston shkelje ligjore në regjistrimin e veturave të reja në Kosovë. Megjithatë, asnjë prej këtyre institucioneve nuk i bëri përshtypje dhe nuk e bindën ministrin Lekaj që të ndryshonte Udhëzimin administrativ.

Të nderuar deputetë,

Tanimë është e qartë se Udhëzimi administrativ 2/2018 është në kundërshtim me Ligjin për automjete, si dhe Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe praktikave më të mira në BE, me të cilin kufizohet konkurrenca në fushën e homologimit të automjeteve dhe cenohet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, për të cilën aq shumë kanë punuar të gjitha institucionet tona.

Duke marrë parasysh gjendjen aktuale, propozojmë që në përputhje me nenin 65, pika 1 dhe 14 të Kushtetutës, dhe nenin 6, pika 1 dhe 14 të Rregullores së Kuvendit të miratohet vendimi si vijon:

1. Menjëherë të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ 2/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
2. Në afat prej dy muajve të hartohet dhe të hyjë në fuqi udhëzimi i ri administrativ, i cili do të jetë në përputhje me Ligjin për automjete, Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe rekomandimet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë;
3. Deri në fund të vitit 2019 të liberalizohet plotësisht tregu i homologimit të automjeteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha e Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Memli Krasniqi, shef i grupit.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni të them që e shpreh zhgënjimin tim që kolegët e opozitës nuk na kanë ofruar fare mundësinë që ne të bëhemi bashkëthirrës të kësaj seance, sepse në ditët e kaluara në Komisionin për Zhvillim Ekonomik ne kemi diskutuar këtë çështje dhe kemi pasur qëndrime në shumicën e pikave të rëndësishme shumë të përafërta dhe sikur të kishin vullnetin që këtë seancë ta bënim bashkë, me siguri që do të thërrisnim bashkë dhe nuk do të rrezikonim atë që me dyshim e kam thënë edhe në mbledhje të komisionit që kjo temë të rrëshqasë edhe një herë si një temë politike dhe jo një temë e karakterit kryesisht ekonomik që ndërlidhet me konkurrencën, që ndërlidhet me çështjet nga kjo fushë.

Sidoqoftë, po shpresoj që nuk ka qenë ky qëllimi, por ashtu edhe po duket.

E dyta që dua ta them më vjen keq që nuk kemi përfaqësues të Qeverisë sot këtu, sepse ne po diskutojmë për një çështje që legjislacioni e ka bërë në kompetencë të Qeverisë dhe së paku në këto raste ne do të duhej të kishim persona përgjegjës për të pasur edhe imputet nga ana e tyre ose perspektivën nga ana e tyre.

Do t'i them disa fjalë fillimisht në lidhje me temën parimore.

Partia Demokratike e Kosovës është fuqishëm pro ekonomisë së tregut të lirë, ky është mbi të gjitha një postulat që te ne buron prej konceptit tonë ideologjik si parti e qendrës së djathtë.

Në këtë kuadër ne jemi në favor të konkurrencës së lirë, fer dhe legale për mundësi të barabarta dhe kundër monopoleve si dhe në pajtim me rendin dhe ligjin.

Çështja konkrete për të cilën sot jemi mbledhur, homologimi, nuk është çështje e sotshme, është çështje e vjetër.

Kjo çështje realisht është diskutua herë pas here ndër vite dhe ndër legjislatura bile dhe ka qenë temë e trajtimeve edhe brenda kabineteve qeveritare, qoftë i tashmi, por edhe i atyre të mëhershme.

Ajo që duhet theksuar që po e dimë që tash përkundër diskutimeve sporadike, asnjë veprim asnjëherë nga askush nuk është marrë deri më tash, kur ne e kemi një insistim edhe nga partnerët ndërkombëtarë ta trajtojmë këtë çështje, gjë që ka sjellë mbajtjen e kësaj seance. Kjo nuk do të thotë që tash është vonë, absolutisht ndonjëherë edhe kur kalojnë shumë vjet, veç mirë që herë do



kur t'i trajtojmë temat të cilat kanë hapësirë për t'i përmirësuar, po cila është çështja. Po flasim për homologimin e veturave, automjeteve, të cilat i ka bërë obligim legjislativ në fuqi.

E dëgjova me shumë vëmendje zotin Zharku, i cili me të vërtetë na dha edhe informacione për rrjedhën dhe për historikun. Po ajo që ndër të tjera më bëri përshtypje është që tha e kemi ligjin në harmoni me direktivat përkatëse evropiane. Nuk është e saktë dhe njëri ndër problemet themelore që e ka sjellë këtë situatë është bash Ligji për automjete.

Ajo që ishte shumë interesante është që ia u referua një vlerësimi të një kompanie private, Grant Thornton, tha ata kanë thënë që ligji është në fuqi me direktivën. Për kohëzgjatje, ne e kemi marrë këtë raport si anëtar të komisionit dhe nga ajo që kemi kuptuar nga administrata është se pikërisht subjekti homologues që e ka monopolin e ka dërguar këtë farë raporti. Tash t'i referohesh raportit që na e ka dërguar subjekti homologues e të merret si referencë që ligji është në pajtim, nuk po më duket krejt mirë.

Sidoqoftë, po e them për një arsye, se ne e kemi një raport të Bashkimit Evropian nga misioni TAEX, një raport i ekspertëve, i cili thotë të kundërtën. Pikërisht raporti i TAEX-it thotë që ky ligj nuk është në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian dhe i specifikon nenet dhe kapitujt e Ligjit për automjete që duhet ndryshuar dhe harmonizuar me direktivën përkatëse të BE-së që ndërlidhet me këtë çështje.

Pra, e kemi një raport të BE-së, zyrtar, që thotë nuk është ligji në përputhje dhe një raport të kompanisë privat që thotë ligji është në përputhje. Nuk po mund ta kuptoj qysh është e mundur në emër të Grupit të LDK-së t'i jepet më shumë relevancë këtij raporti, sepse ne e dimë me të vërtetë ligji nuk është mirë. Ligji absolutisht ka defekte dhe nuk është defekt vetëm te çështja e homologimit, ka pasur edhe defekte të tjera, për historikun e tij mund ta thirrni edhe një seancë tjetër të jashtëzakonshme se i keni bërë trend, dhe mund të bisedojmë si ka buruar dhe si është bërë ligji, se zoti Zharku ka qenë ministër, unë besoj e ka pruar në Kuvend një ligj shumë herë më të mirë se sa ligji që ka dalë në fund. Sepse këtu në këtë Kuvend, edhe për interesa shumë të ngushta personal, edhe të deputetëve të asaj legjislature, ky ligj ka ndryshuar dhe sot ne e kemi në fuqi, përkundrazi defekteve të mëdha që i ka.

Pra për homologimin konkretisht ligji e ka specifikuar këtë çështje dhe çka është shumë me rëndësi të thuhet, ligji nuk e sanksionon monopolin, legjislativ dhe kjo është më e rëndësishme për mendimin tim, nuk thotë duhet pasur monopol, përkundrazi, legjislativ krijon hapësirë për konkurrencë të lirë në treg.

Tani është çështja tjetër e aktit nënligjor.

Udhëzimi administrativ, i cili përsëri nuk e pengon konkurrencën e lirë, por e vështirëson dhe në diskutimet që i kemi pasur edhe në takimet e fundit unë kam kërkuar edhe nga ministri Lekaj që

të bëhen ndryshimet, në mënyrë që të krijohet hapësira sa më shpejtë që është e mundur për një konkurrencë pas 10 vjetësh të skadimit të asaj marrëveshje që efektivisht e ka krijuar mundësinë për të pasur vetëm një operator në treg.

Pra, dispozitat imituese unë besoj që është urgjente të adaptohen, ndryshohen dhe të mos pengohet përmes tyre konkurrenca e lirë.

U përmend edhe diçka interesant, po i referohem zotit Zharku, meqenëse vetëm ai foli.

Vendimi i Qeverisë së kaluar prej muajit gusht të vitit 2015 që tha kundër monopoleve. Unë e kam votuar atë vendim, kemi qenë bashkë në atë farë qeverie edhe me juve zoti kryesues, në gusht 2015, gati edhe 2 vjet e kemi pasur qeverisjen bashkë, asnjë hap, asnjë zbatim, asnjë lëvizje.

Nuk mjafton t'i referohesh e të thuash i kemi pasur do juristë, na kanë këshilluar, këqyr ndoshta bën, ndoshta nuk bën. Unë ju garantoj edhe sot në Ministri të Infrastrukturës ka juristë që i thonë njëjtë ministrit aktual, nuk bën ose bën, kush janë ata juristë, ku janë ato raporte, a keni pasur një farë raporti të TAEX-it, nuk kemi ndërmarrë masa, fajin e kemi bashkë. Nëse ka këtu faj, fajin e kemi të përbashkët, s'është për ta relativizuar, por Qeverinë si të thuash e keni udhëhequr ju, bashkë me PDK-në, atë kohë. Nuk ka penguar askush marrjen e veprimeve, tek e fundit kemi mundur të provojmë, të njëjtën gjë po e kërkojmë sot, edhe prej kësaj Qeverie. Të thuhet kanë qenë disa juristë brenda dhe jashtë ministrisë, kanë pas thënë nuk bën, po vendimi është i Qeverisë, është më i rëndësishëm se sa këshillat e juristëve, sepse sot mund të vijë këtu ministri dhe i citon disa këshilltarë që thonë 'jo, mos e shfuqizo kontratën', ose interpreto nenin 34.2, ashtu qysh e ka interpretuar, e jo qysh e interpretuan të tjerët.

Meqenëse koha po shkon, unë po dua ta thjeshtëzoj këtë çështje. Bazuar në ligj, tregu duhet hapur. Mundësia për investime të tjera ekziston, po ajo duhet përsheptuar dhe fuqizuar. Dispozitat limituese, qofshin aktet ligjore apo nënligjore duhet ndryshuar sa më shpejt që është e mundur dhe çështje e tjera që ndërlidhen me praktikën, pjesën e fundit së homologimit, të cilat absolutisht nuk besoj që janë të arsyeshme, siç është homologimi i veturave të reja dhe çështja e certifikatave të konformitetit të veturave që vijnë të importuara në Kosovë nga shtetet e Bashkimit Evropian as që duhet të diskutohet.

Unë nuk besoj që është normale që një veturë e re që vjen në Kosovë prej BE-së t'i nënshtrohet një procesi të verifikimit edhe një herë në Kosovë kur i ka letrat, përveç asaj që këto ditë e kemi mësuar në këto takime që quhet homologim i tipit, por jo secila veturë që hyn në Kosovë. Pra, unë besoj nëse ka vullnet ne mund të pajtohemi shumë shpejt për këto çështje. Legjislacioni ekziston, është kundër monopolit, krijon hapësirën për konkurrencë të lirë. Nëse ka dispozita në akte ligjore ose nën ligjore që e limitojnë ose vështirësojnë këtë çështje,

duhet t'i ndryshojmë sa më shpejt dhe këtë çështje mund ta bëjmë, edhe e treta, ta obligojmë Qeverinë që sa më parë të ndërmarrë masa për hapjen e tregut dhe të mos lejohen monopole në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar kolegë,

Dhe, ju qytetarë të Republikës së Kosovës që po na ndiqni, mendoj që autoriteti më kompetent në kuptimin profesional të fjalës sa herë flasim për këtë çështje, unë mendoj që është Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës. Ata prej vitit 2006 deri në vitin 2018, siç dihet e kanë bërë atestimin e automjeteve në Republikën e Kosovës, por është e dhimbshme qysh ministri Lekaj, në të njëjtën kohë që e ka marrë Udhëzimin administrativ për vazhdimin e homologimit ndaj kompanisë “Euro-Labi”, në të njëjtën kohë ia ka shkëputur marrëveshjen Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës për ta bërë atestimin e automjeteve në Republikën e Kosovës.

Kështu që ministri Lekaj nuk mund të fshihet duke thënë që ne e kemi konsultuar çdo autoritet profesional dhe kurrkush nuk na ka dërguar vërejtje apo sugjerime. Unë me qëllim e mora këtë dokumentin 22 faqesh nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, ata kanë bërë vërejtje shumë profesionale ndaj Udhëzimit administrativ të Pal Lekajt dhe prej krejt vërejtjeve që unë i lexova me shumë vëmendje, ata konstatojnë në një letër ankesë që asnjëra prej vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre nuk është marrë në konsideratë nga ministri Lekaj. Për shembull, sidomos për këtë nenin më problematik, i cili faktikisht është ajo esenca e garantimit të monopolit në Udhëzimin administrativ që është neni 7, pika 4 e Udhëzimit administrativ të ministrit. Aty ku formulohet faktikisht e zeza mbi të bardhë, formulimi i monopolit lidhur me shfrytëzimin mesatar të kapaciteteve prej 85%. Shikoni se çka i shkruan fakulteti ministrit Lekajt kur ai ia kërkon mendimin fakultetit për këtë Udhëzim. Fakulteti ia kthen përgjigjen se “ky nen nuk është i nevojshëm dhe duhet të hiqet. Nuk e lejon konkurrencën e lirë dhe e lejon monopolin në shërbimet e homologimit dhe nuk ofron mundësi për subjektet e reja që të konkurrojnë për homologim”.

Këtë mendim ia dërgon Fakulteti i Inxhinierisë Pal Lekajt dhe Pal Lekaj nuk e përfill fare, e formulon në Udhëzim administrativ monopolin edhe vazhdon tutje. Kjo është e vërteta sa i respekton Pal Lekaj edhe kjo qeveri mendimet e autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës, por kjo, thënë të drejtën, i hap edhe do probleme të tjera. Për shembull, politikën arsimore në Republikën e Kosovës nga kjo Qeveri, na e kanë çarë kokën duke thënë që Ministria e Arsimit është për inkurajimin e fakulteteve, sidomos këto që janë të dimensionit teknik që të gjenerojnë të hyra vetë, përmes aktiviteteve të ndryshme. Njërin prej gjenerimeve kryesore të këtyre të hyrave që e kemi pasur në Fakultetin Teknik të Inxhinierisë Mekanike, ministri ia ka ndërprerë. Kjo e ka dëmtuar edhe në aspektin e të hyrave Universitetin, edhe në aspektin

profesional, sepse aty studentët kanë mundur të shohin konkretisht edhe të bëjnë praktikën aty e të përfitojnë njohuri shumë të vlefshme profesionale, pastaj për zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre profesional.

Në rastin e homologimit, zonja dhe zotërinj, i kemi dy krime të mëdha: krimi i parë është i vitit 2008, edhe ai është me Udhëzim administrativ, në të njëjtën mënyrë. Atë Udhëzim administrativ e ka marrë ministri i atëhershëm, Fatmir Limaj, në vitin 2008 duke e keqinterpretuar qëllimisht ligjin e atëhershëm për sigurinë në komunikacion, shkon edhe e shkruan një Udhëzim administrativ duke e pasur në mendje saktësisht një kompani të caktuar, të cilin e përgatisin t'ia dhënë një fushë, prej të cilës ka shumë përfitim, siç është kjo procedura e homologimit në Kosovë. Por, ajo kontratë i ka 10 vjet, 10 vjet afat dhe krimi i dytë është bërë kur kësaj kontrate iu ka afruar fundi edhe në vend se të shfrytëzohet rasti e të ketë vullnet politik për ndërprerjen e kësaj kontratë, në kuptimin që jo të ndërpritet me zor, por ajo e ka pasur afatin e vet, Pal Lekaj e merr Udhëzimin administrativ të vetin, i cili në mënyrë automatike ia siguron vazhdimësinë monopolit në homologim kompanisë “Euro-Labi”. Edhe vendimi i vitit 2008, edhe ky vendimi i vitit 2018 nga Pal Lekaj qartazi janë antikushtetues, të dytë janë në kundërshtim me nenin 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili nen në Kushtetutë qartazi e ndalon monopolin në Republikën e Kosovës. Përveç kësaj, edhe autoritetet e tjera kompetente kanë dhënë vlerësimin që ky ligj i shkel ligjet e tjera, ky Udhëzim administrativ i shkel ligjet e tjera. Për shembull, opinioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, i cili thotë që ky Udhëzim administrativ e shkel Ligjin e konkurrencës në Kosovë, prapë nuk dëgjon ministri Lekaj dhe nuk merr vesh.

Të gjitha këto që po flasim po ju kujtohet kur kanë ndodhur, në vitin 2008, ashtu edhe një vit më vonë, më 2009 me Z-Mobile, pra dy vjetët e para të pavarësisë së Kosovës, në kohën kur erdhi menjëherë në pushtet Qeveria “Thaçi 1” dhe populli ishte ende në atë entuziazmin e festës së pavarësisë, të gjitha këto vendime të dëmshme janë marrë atëherë, në atë kohë.

Sa i përket konfliktit të interesit Zyra e BE-së, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë ka ngritur shumë shqetësime kur ka pretenduar përmes një letre që ia ka dërguar Pal Lekajt që ka marrë vesh që urdhri i tij administrativ është shkruar së bashku me zyrtarët e “Euro-Labit”, janë ulur së bashku e kanë shkruar Udhëzimin administrativ, ky është konflikt i qartë i interesit, konflikti i dytë i interesit. Ky zotëria Shatri, që ishte njeriu kompetent që ka negociuar me “Euro-Labin” dhe e ka shkruar Udhëzimin administrativ, e ka përpiluar në kuptimin teknik, ky ka deklaruar të ardhura prej “Euro-Labit”. Ka të hyra prej “Euro-Labit”, ky është konflikt i qartë i interesit, kjo është vepër penale, vepër e rëndë penale e konfliktit të interesit.

Homologimi mund të preket edhe nga dimensionet e tjera, ne kemi krijuar një situatë të frikshme kur databazën më të rëndësishme të automjeteve e ka një kompani private dhe ti edhe kur të shkëputet kontrata me atë kompani, ajo do të jetë më e fuqishme se Ministria e Punëve të

Brendshme, sepse prej fotografive të veturave e përshkrimit krejt teknik të çdo detaji të veturës e ka ajo kompani private, e ne edhe disa kompetenca shumë të rëndësishme, të cilat i ka në dorë shteti gjithkund në Perëndim, ne ia kemi dhënë një kompanie private. Kjo është e tmerrshme!

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha e Grupit Parlamentar të AAK-së, kush e donë fjalën? Ahmet Isufi, urdhëro!

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo seancë e thirrur ka një qëllim që të dalë në pah se çka është duke u bërë me homologimin e automjeteve, e nëse është ky qëllim është mirë të përgjigjemi drejtpërdrejt. U përmend këtu disa herë Pal Lekaj, Pal Lekaj nuk është krijuar i kësaj situatë. Krijues të kësaj situatë që nga viti 2008 janë partitë që kanë qenë në pushtet, edhe më së paku kanë të drejtë të flasin ata, të cilët kanë ushtruar autoritetin, kanë pasur përgjegjësi institucionale, sikur ministri i Infrastrukturës dhe nuk i kanë bërë ndryshimet. 10 vjet janë në pyetje për 11.

Në vitin 2009 ka filluar homologimi, ka filluar me të njëjtën kompani dhe në të njëjtën mënyrë. Po ashtu, në vitin 2017 ne kemi Ligjin për automjetet që, në fakt, i lejon ose i mundëson fushëveprimtarinë kësaj kompanie, e cila edhe më tutje është në angazhim. Merreni nënën 34, pikën 2 dhe shikojeni pra, pse keni lejuar të ndodhë kjo? E vetmja mënyrë për ta ndryshuar këtë gjendje, urdhëroni e marrim e ndryshojmë Ligjin për automjetet dhe e paraqesim konkurrencën e lirë në treg. Nëse doni ta ndryshoni gjendjen, por nuk e keni ndryshuar për 10 vjet me radhë. Po ashtu, ta dini një gjë, ne jemi kundër monopolit, sepse nuk është mirë në një shoqëri demokratike, në një shoqëri ku vendosen normat, standardet, të cilat janë të preferuara edhe nga shtetet e Bashkimit Evropian e të marrim modele të mira, por duhet të ndryshohet ligji. Po ashtu, jemi kundër centralizimit, pse të jetë vetëm një qendër në të cilën bëhet homologimi, kur ka mundësi të hapen disa qendra në nivel Kosove dhe të mos detyrohen njerëzit të udhëtojnë, të paguajnë plus transporte, sepse një veturë e re e cila duhet të homologohet duhet të hipë në atë 'karrotrecin', si i thonë, për ta sjellë deri te Qendra e Homologimit. Pse nuk bëhet pra decentralizimi në kuptimin e homologimit, në mënyrë që qytetarët të mund të bëjnë shërbimin ashtu si duhet.

Po ashtu, nëse çmimet janë më të larta, madje se edhe të disa vendeve të Bashkimit Evropian, kjo s'ka asnjë kuptim me nivelin e standardit të jetës së qytetarit tonë në Kosovë. Përkundrazi, edhe në këtë duhet të vepohet, në mënyrë që të ndryshohet gjendja. Dhe, po ashtu konsideroj që është krejt absurd nëse një automjet i ri i homologuar në një vend kudo tjetër të vijë në Kosovë dhe të detyrohet edhe një herë t'i hyjë të njëjtës procedurë për të harxhuar e për të përfituar dikush, nuk është absolutisht në rregull kjo dhe duhet ne me ligj të bëjmë sanksionimin e këtyre elementeve, të cilat po përmenden këtu. Dhe, përfundimisht po ju them, ka përfitues, të cilët janë të lidhur edhe me kompaninë dhe është mirë, mos u fshihni, është mirë të tregohet kush janë ata që në të

vërtetë po i bëjnë këto përfitime. Sepse, Qeveria e tashme e ka marrë këtë gjendje komplet qysh e keni sjellë deri këtu ju, bile më së paku kanë të drejtë ata që kanë qeverisur, kanë përfituar, dhe tash sulmojnë këtë qeveri. Unë e di që i prodhon ligjet Qeveria, por plotësim ndryshimin e tyre mund ta bëjmë këtu ne në Parlament dhe të mos i biem në qafë kurrkujt para se t'i biem vetvetes, sepse Ligji në 2017 këtu e ka votuar ky Parlament. Urdhëroni, për një javë ditë mund t'i bëjmë ndryshimet e duhura dhe nuk është mirë veç për propagandë të përdoret foltorja, por është mirë që t'i hyjmë ndryshimit edhe plotësimin të ligjit, në mënyrë që ta kemi një ligj, i cili edhe e lë konkurrencën e lirë, edhe mundëson me nenet e caktuara që të ndryshohet gjendja, sepse kështu veç mund të bëjmë potere, por përfituesit ende mbeten në skenë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, Shqipe Pantina.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, nënkryetar!

Në fakt, pa dashur të ndalemi në detaje se kush i ka pasur fajet për gjendjen në të cilën jemi tani për problemin për të cilin po diskutojmë, pra për homologimin, fillimisht ndoshta duhet të diskutojmë nëse si i tillë është i nevojshëm apo jo. Pse duhet makinat, të cilat vijnë sidomos ato nga Bashkimi Evropian, ku ne po synojmë të bëhemi pjesë e ku në secilin ligj po mundohemi ta harmonizojmë me ato të BE-së, pra me 'acquis communautaire', pse është i nevojshëm si i tillë, si proces. Mendoj se kjo duhet të jetë fillimisht pika e diskutimit.

Cilat janë përfitimet që i kanë në këtë rast konsumatorët, por qytetarët tanë nëse makinat e tyre kalojnë përmes këtij procesi, pra nëse bëhet homologimi? A do të thotë kjo që jeta e njerëzve, sidomos atyre që janë në rrugë do të jetë më e sigurt. Sa ka ndikuar kjo që të ulet numri i aksidenteve me fatalitet, sepse makinat kur vijnë në Kosovë, e kalojnë një proces i cili përveç se është i kushtueshëm, pra u kushton qytetarëve, pronarëve të makinave nuk mendoj që ka sjellë ndonjë dobi tjetër për vendin dhe për qytetarët. Nuk mendoj se as ka ndikuar në rritjen e buxhetit, sepse siç u tha edhe këtu, përfitimet më shumë kanë shkuar në xhepa të atyre që kanë pasur tashmë se sa që ka përfituar buxheti i shtetit, e më së paku qytetarët, gjegjësisht ata që janë pronarë të makinave.

E dyta, natyrisht se ne jemi kundër monopolit, shteti duhet të vërë rregulla, e pastaj të kujdeset që këto rregulla të zbatohen, pra t'i mbikëqyrë zbatimin e këtyre rregullave e kjo nuk besoj se ka ndodhur, jo vetëm me procesin e homologimit i cili bëhet vetëm një herë, por sidomos me procesin e kontrollit teknik. Natyrisht se ka disa përmirësime, duhet ta pranojmë, por megjithatë, prapë ne e kemi diskutuar edhe këtu në Kuvend për numrin e madh të aksidenteve me fatalitet që ndodhin nëpër rrugët tona dhe një nga shkaktarët e saj është edhe fakti se në rrugë ne kemi makina, të cilat nuk i përmbushin kushtet teknike. Pra, kontrolli teknik, i cili bëhet vit për vit, në shumë raste bëhet shkel e shko sa për ta lëshuar atë vërtetimin i cili duhet për ta regjistruar makinën.

Pra, edhe kjo është një çështje që duhet të diskutojmë. Ato rregulla që ne i kemi vendosur, ato që janë në disfavor, nëse nuk janë në të mirë as të shtetit, buxhetit, por as të qytetarëve, në këtë rast konsumatorëve, a duhet t'i ndërrojmë dhe, e dyta si t'i monitorojmë zbatimin dhe si të kujdesemi se këto rregulla që janë të mira të zbatohen, sepse edhe ky është problemi që e kemi, natyrisht, jo vetëm me këtë çështje, jo vetëm me homologimin apo kontrollin teknik, por me shumë probleme tjera. Kështu që këto janë çështje që duhet diskutuar, rekomandimet që ne i kemi marrë për, kjo quhet "vendim", nuk e di Kuvendi a nxjerr vendim, zakonisht jemi mësuar të nxjerrim rezoluta, por ne jemi dakord me to nuk e di a ka pasur nevojë të bëhet një seancë të jashtëzakonshme, sepse me sa dimë kjo tashmë është diskutuar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe të njëjtat rekomandime i janë dhënë ministrisë atje dhe prapë po them, pa dashur tash të lëshohemi se nuk e zgjidhim problemin nëse ne e drejtojmë gishtin kah fajtorët, a është më shumë fajtor PDK-ja apo LDK-ja, që kanë qenë në pushtet deri më tani, e të dy këto parti kanë menaxhuar me Ministrinë e Infrastrukturës, apo më shumë fajet i ka AAK-ja që tashmë është duke e drejtuar këtë ministri, por të fokusohemi kah zgjidhja e problemit, dhe jo vetëm ta zgjedhim problemin e homologimit, i cili siç thashë mendojmë se sidomos për makinat që vijnë nga shtetet e Bashkimit Evropian duhet të hiqet fare, por edhe të diskutojmë edhe për kontrollin teknik të makinave, a bëhet si duhet dhe a duhet edhe aty të ndërrohet ndonjë rregull, apo të forcohen më shumë mekanizmat e monitorimit të këtij procesi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Lista serbe s'është asnjë deputet në sallë, Nisma Socialdemokrate? Bilall Sherifi, urdhëro!

**BILALL SHERIFI:** Përshëndetje i nderuar kryesues!

Përshëndetje të nderuar kolegë,

Sot jemi thirrur në një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar një çështje që është aktualizuar, ka qenë disa herë temë diskutimi, por është aktualizuar pasi që kemi të bëjmë me ripërtëritjen e një kontrate, për të cilën ka pasur një debat jashtëzakonisht të gjerë publik. Dikush e ka quajtur si një kontratë që ka pasur për bazë dhe për qëllim sigurinë në komunikacion, dikush e ka shpallur atë si një kontratë për interesa personale, partiake e private, ku ta di unë, secili interpretimi ka motivet për të cilat edhe e ka bërë.

Sidoqoftë, le të mbetet në ndërgjegjen e secilit që për qëllim nuk ka të vërtetën, por ka propagandën, në fund të fundit, secili ka të drejtë të përcaktohet se me çfarë mjete dëshiron të shërbehet, me propagandë apo me të vërteta, por herët apo vonë, vjen një moment kur bëhet peng i tyre dhe atë e zënë për fundi. Unë do të përpiqem të shpjegoj jo se çka ka ndodhur para 10 vjetëve, sepse ajo më tani dihet ka qenë një nismë e qeverisë së atëhershme, ku është kërkuar sipas standardeve ndërkombëtare të bëhet edhe homologimi i veturave edhe në Kosovë dhe si metodologji e kanë përzgjedhur atë rrugë, të cilin e kanë zgjedhur bazuar në ligjet e atëhershme në fuqi dhe përmes një Udhëzimi administrativ është hapur interesi shpallje publike dhe nuk është dhënë si monopol, por i është dhënë një kompanie, sepse nuk ka pasur tjetër që ka

konkurruar. Kjo megjithatë le t'i mbetet të kaluarës, tani jemi në momentin ku jemi. A duhet kontrata e tillë të vazhdohet apo jo dhe çka duhet të bëjmë?

Këtu u fol që jemi kundër monopoleve si qendra të djathta, ndërsa kemi së paku një monopol privat që është KEDS-i. Pra, dhe nëse e zgjidhim këtë çështje përmes një rezolute, vendimi, amendamentimit të ligjit apo shfuqizimit të këtij akti nënligjor, udhëzimet administrative, nuk e kemi zgjidhur çështjen e monopolit, monopoli do të vazhdojë të jetë madje edhe shumë më i dëmshëm për vendin se sa ky i homologimit. Por, le të sqarohemi pak se së paku nga këndvështrimi im se janë krijuar paqartësi për publikun përmes propagandës së rish, se homologimi është i barabartë me kontrollin teknik. Nuk kemi të bëjmë me kontroll teknik. Kur flasim për homologim, kjo gjë nënkupton lejen që një autoritet i një vendi të caktuar, i një shteti, jep një llojit, një tipit, të veturës për të lëvizur në territorin e tij. Homologimi bëhet edhe në Gjermani, bëhet edhe në Francë, bëhet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, bëhet edhe jashtë vendeve të Bashkimit Evropian dhe unë vetëm desha këtu, kam sjellë që ta ndaj me ju një informatë. Për shembull, është në gjuhën gjermane, do të përpiqem ta parafrazoj një lajm ku merret vendim që veturat të cilat kanë qenë të lëshuara në treg në Gjermani t'i nënshtrohen kontrollit të homologimit. Pra, është dyshuar edhe në vetë autoritetin që ka bërë homologimin e veturave në Bashkimin Evropian. Pra, janë homologuar, janë lëshuar në treg dhe kontrollet periodike të herëpashershme kanë ardhur në përfundim se edhe prodhuesit kanë mashtruar.

Pra, homologimi ka për qëllim të detektojë edhe mashtrimin që bëjnë vetë prodhuesit, lëre më importuesit dhe transportuesit, po edhe vetë prodhuesit. Dhe, është marrë vendim në vitin 2017 që në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, pra ministrat e industrisë së vendeve të Bashkimit Evropian kanë marrë vendim që të kontrollojnë dhe për çdo veturë që do të zihet, të kapet, se është në kundërshtim me standardet e homologimit, të dënohet deri në 30 mijë euro për çdo veturë që kapet se ka mashtruar. Bëhet fjalë për një proces, për të cilin nuk ka të bëjë me aspektet teknike, por me vlerat që shkruhen në certifikatën e veturës. A i ka ato që shkruhen apo jo?

Bashkimi Evropian dëshiron të ashpësojë rregullat e homologimit. Kjo është në gjuhën gjermane, e keni në Google, kurdo që dëshironi të hyni mund ta gjeni se kemi të bëjmë me një proces të vazhdueshëm, me një betejë të vazhdueshme me prodhues dhe me importues. Çka duam ne të bëjmë? Duam ta heqim atë, siç thuhet, sepse po vijnë nga Gjermani? E heqim, se vijnë nga Franca? E heqim, s'ka problem! Po ata vetë nuk po e heqin, ata vetë po ia nënshtrojnë kontrollin e herëpashershëm veturave që vetë i certifikojnë.

Unë kam shqetësime. Nuk e di a bëhet homologim këtu te ne, apo nuk bëhet, këtë nuk e di! Apo, në emër të homologimit bëhen vetëm kontrolle teknike, këtë nuk e di, nuk jam ekspert. Por, nëse këtu bëhet homologim, atëherë na del se sipas standardeve të Bashkimit Evropian homologimi është i domosdoshëm, në vazhdimësi madje, kontrolle të herëpashershme, se na kanë mashtruar apo nuk kanë mashtruar prodhuesit. Keni dëgjuar herë pas herë që tërhiqen nga 100 mijë a 200



mijë vetura nga tregu, pikërisht për këto arsye, se kapen në mashtrim. Apo, le të mos e quajmë mashtrim, herë pas herë edhe me defekte.

Tani dalim te kjo se çka duhet të bëjmë sot. Po, kolegë të nderuar, jemi për konkurrencën e lirë. Do të angazhohemi që jo vetëm në këtë fushë, por në të gjitha fushat të rregullojmë këtë çështje dhe ne nuk mendojmë se është i mjaftueshëm ky hap. Ne mendojmë se duhet Ligji antimonopol të kalohet në Kuvendin e Kosovës bazuar në Kushtetutë, sepse nuk mund të thirresh në një nen të Kushtetutës për një çështje dhe të anashkalosh çështjen tjetër. Nuk mendoj se ne duhet veç e veç në çdo fushë të rregullojmë çështjen e monopolit, por duhet me një ligj të veçantë të gjitha mono-polet t'i ndalojmë, të cilat natyrisht se mund t'i nënshtrohen konkurrencës së lirë, sepse nuk them se do të duhet edhe armë të prodhojmë privat, se atëherë do të ishte... Zoti e di se çfarë do të ndodhte këtu. Por, për të gjitha çështjet që do të mund të ofrohen shërbime edhe më shumë se një privat, pra nëse një gjë mund t'i ofrohet privatit në monopol, atëherë mund t'i ofrohet edhe dy, edhe tre, edhe katër. Pra, nëse KEDS-i mund të operojë si privat, atëherë mund të operojnë edhe disa kompani të tjera, pse jo?

Në shumë vende ku unë edhe disa nga ju kemi jetuar, apo e dini se si zhvillohet, edhe shërbimet e shpërndarjes së energjisë elektrike, të distribuimit, janë të demonopolizuara. Edhe aty ka më shumë se një, dy e tre ofrues. Pra, rrjeti vihet në dispozicion për të gjithë ata që dëshirojnë të blejnë dhe të shesin energji elektrike, edhe për të gjithë ata që dëshirojnë të ofrojnë shërbimin e homologimit. Ne do të angazhohemi si Nismë që të jemi bashkëpunues në këtë pikë. Nuk jemi fare të interesuar që të dëmtohet publiku, sidomos të dëmtohen individë që dëshirojnë të importojnë një veturë, dy apo tre, por homologimi nëse mbetet, nëse dëshironi që të hiqet homologimi, atëherë duhet të keni telashe me standardet e Bashkimit Evropian, sepse ata kërkojnë që çdo vend të ketë shërbimin e homologimit. Ama duhet të dimë a po ofrohet vërtet shërbim homologimi apo vetëm po bëhet kontroll teknik në emër të homologimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar 6+ s'është paraqitur askush. Është radha e përfaqësuesit të Qeverisë, por Qeveria s'ka asnjë përfaqësues këtu. Unë duhet t'ju njoftoj se ministri Lekaj ka bërë me dije, ka njoftuar Administratën e Kuvendit që sot nuk ndodhet në Kosovë.

Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të mundohem të flas shkurt, sepse edhe tema si e tillë kërkon më shumë vendimarrje legjislative dhe që ndërlidhet me pjesën ekzekutive, por pasi që është kërkesë për debat dhe për të nxjerrë konkluzione, ashtu siç po pretendojmë për të parandaluar një të keqe, e cila shfrytëzohet në kundërshtim me interesat e qytetarëve të vendit.

Tash, kjo nuk do, ndoshta, ndonjë analizë të thellë vetëm për të përdorur metoda krahasimore, se sa gjobiten qytetarët dhe çka përfitojnë nga i ashtuquajturit “homologim”! Edhe në fjalën e hyrësit në kërkesën që determinon tërheqjen e monopolit, por kjo ngërthen në vete edhe fitimet, edhe shumat, të cilat përcaktohen dhe që në gjuhën popullore është vetëm një plaçkë, e cila është vendosur që nga vendosja e saj dhe vazhdon e dhe sot.

Pse them unë “plaçkë”? Sepse, nëse një çmim prej 125 eurove me një standard çfarë e kanë qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërsa nëse në rajon sillet nga 30 dhe maksimumi deri në 70 euro, kjo është tregues se individë dhe struktura të lidhura edhe me krimin e organizuar janë burim i kësaj së keqeje. Kjo nuk do ndonjë koment tjetër. Mbi të gjitha, kur Kosova nuk është prodhues automjetesh, sepse ne nuk prodhojmë as Mercedes, as BMW, as Fiat, po as Ferrari, se edhe këto po të vijmë në Kosovë me 00 duhet t’i nënshtrohen homologimit dhe paramendoni, se çka duhet të paguajnë qytetarët e Republikës sonë.

Andaj, sot Kuvendi duhet të ballafaqohet me një të vërtetë, që tregon edhe realitetin e sotëm të kësaj seance, ku nuk është asnjë përfaqësues i Qeverisë dhe ku ka mungesë të madhe, të konsiderueshme, të deputetëve të Republikës së Kosovës. Kjo tregon se individë dhe struktura ndonjëherë janë edhe mbi institucionet. Unë dyshoj se kjo ndërlidhet me fitimin dhe shpërndarjen e këtyre fitimeve, që bëhet nga homologimi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë se ky është biznes individual dhe paramendoni, vetëm për vitet 2017, 2018, 2019 fitimi sillet rreth 4 milionë euro në këtë biznes. Arsyeshmëria që shumat janë të mëdha për shkak të shpenzimeve operative nuk qëndron, sepse shpenzimet operative të paraqitura në Administratën Tatimore sillen nga 276 mijë euro deri në 350 mijë euro dhe tatimet që paguhen komplet, duke përfshirë edhe personelin, zhvlerësimet, fitimet, tatimin në të ardhura, nuk kalon më shumë se 2 milionë euro, ndërsa fitimi neto është mbi 4 milionë euro. Sigurisht, kur kanë menduar të shpërndarja e shpenzimeve, kanë menduar në shpërndarjen e shpenzimeve të atyre që qëndrojnë prapa kësaj çështjeje që nga fillimi, e thashë këtë edhe një herë. Ata që kanë nënshkruar që kjo të ketë monopol, që të ketë çmime fikse dhe të mos i nënshtrohet asnjëherë, as lirimit, as rishikimit, por kjo të paguhet nga qytetarët tanë pa asnjë bazë, qoftë edhe morale apo ligjore.

Andaj, sot Kuvendi duhet ta marrë një vendim mbi vullnetin e këtyre palëve të përfshira në këtë krim të organizuar dhe ta thotë me guxim të plotë se kjo nuk guxon t’u ndodhë qytetarëve të vendit. Tek atëherë ne mund të arsyetohemi me ligje, me udhëzime administrative, me kërkesa individuale, me kërkesa politike dhe kjo është përgjigjja që mund të marrin rreth kësaj çështjeje. Përndryshe, sa për rezoluta e sa për kërkesa kështu, edhe gojore, edhe në raport me mediet, qytetarët prapë do të vazhdojnë të paguajnë nga 125 euro pa asnjë dallim dhe pa asnjë arsye, madje edhe ata që importojnë makina me 00 kilometrazh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë dhe ju të pranishëm,

Unë nuk kam çfarë t'i shtoj më tepër asaj që e tha shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi, sa i përket orientimit dhe përcaktimit të Partisë Demokratike në lidhje me respektimin e tregut të lirë, në lidhje me atë se Kosova një herë e përgjithmonë ka zgjedhur të orientojë ekonominë e saj në modelin e ekonomisë së lirë, ku interesi i qytetarëve mbetet element qenësor i vlerësimit të përshtatshmërisë së ndërhyrjes së shtetit në rregullimin e saj.

Dëshiroj këtu ta ripërsëris se unë duke qenë kryetare e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në momentin që përfaqësuesja e BE-së, zonja Apostolova, ka bërë një kërkesë urgjente për t'u sqaruar në lidhje me Udhëzimin administrativ që lidhet me homologimin e veturave, kam ftuar komisionin dhe aty e kanë dhënë opinionin e vet të gjithë deputetët. Shqetësuese është se për çështje të rëndësishme që lidhen me të gjithë qytetarët e Kosovës nuk është mirë që neve të na ndajë në ngjyime politike dhe të drejtojmë gishtin apo të jemi tabelë qitjeje reciproke, se kush i ka fajet, ajo qeveri apo kjo qeveri.

Vlen të përmendet se duke u bazuar gjithmonë në atë që e ka ngrehur si shqetësim zonja Apostolova, por edhe natyrisht duke u bazuar në dy dokumente të rëndësishme: në dokumentin e ekspertëve të TAEX-it, që ka ardhur përmes Apostolovës, ku ngrihet shqetësimi se "Procesi i regjistrimit të mjeteve të reja në Kosovë ka shkelje ligjore në bazë të dispozitave të Direktivës 2007/46, nenit 4 dhe 26 të Direktivës", si dhe është kërkesë decitive që duhet të ndryshohet kapitulli 5 i nenit 30 dhe 33 të Ligjit për automjetet, që këtu dikush tha se ligji nuk është pengesë për të luftuar monopolin. Në fakt, ligji në nenet e posaçme në përgjithësi ka nga pak huti, sepse përderisa te një nen i jepet mundësia që të hapet tregu, në nenet tjera i vështirësohet, e kështu me radhë. Ne si deputetë duhet që urgjentisht të bëjmë diçka në këtë drejtim dhe të vijmë deri te plotësimi dhe ndryshimi i ligjit. Ndërkohë që edhe raporti i progresit ka ngrehur shqetësimet lidhur me monopolin në Kosovë, ku thotë se në Kosovë ekzistojnë monopole të një natyre tregtare, në kuptim të nenit 37, marrëveshja ekskluzive me një kompani private lidhur me homologimin e detyrueshëm të automjeteve për të gjitha automjetet e importuara është shqetësuese.

Ajo që dëshiroj ta përsëris është se edhe ne si Parti Demokratike e Kosovës do të kërkojmë që Udhëzimi i ri administrativ të garantojë konkurrencë të lirë dhe në interes të qytetarëve, që interesi i qytetarëve të jetë parimi bazë që duhet të udhëhiqen politikat e Qeverisë. Gjithashtu, duhet ripërsëritur dhe nuk është e tepërt se duhet vënë në vëmendje të publikut se procesi i homologimit të aplikohet edhe ndaj makinave të reja që kanë origjinë vendet e Bashkimit Evropian dhe ndaj të cilave standardet e certifikimit të përshtatshmërisë së tyre për tregun

evropian janë të garantuara. Duke njohur se Kosova në procesin e homologimit aplikon vetëm ato standarde që kanë burim Bashkimin Evropian apo edhe vendet individuale që janë pjesë e tij, nuk ka kurrfarë arsyeje ricertifikimi i përshtatshmërisë së këtyre automjeteve për të operuar në tregun e Kosovës.

Kjo përndryshe është vetëm një barrierë e dukshme jotarifore dhe kundër Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe po më duket në këtë pikë ishim të gjithë të përbashkët dhe është mirë që këto çështje të mos i bëjmë vetëm për popullizëm, t'i ngremë dhe kur kemi mundësi edhe në instanca të tjera, kemi pasur mundësi, edhe në komision parlamentar, sepse dëshiroj ta përkujtoj se në këtë Kuvend silltet nëpër çdo seancë Ligji për automjetet që nuk votohet në tërësi, ndërkohë që asnjëri nga deputetët, të cilët sot edhe e kanë thirrur këtë seancë të vetëm, pa i përfshirë të gjithë, nuk e ka ngrehur si shqetësim se është pengesë monopoli, që në njëfarë forme e vështirëson hapjen e tregut të lirë edhe të Ligji i automjeteve. Për të mos hyrë në historik, sepse kam qenë pjesë edhe e legjislaturës së kaluar, edhe pjesë e atij komisioni kur ka ardhur edhe drafti nga ministria, që ka qenë zoti Zharku ministër në atë kohë dhe pastaj ndryshimet që kanë ndodhur gjatë fazave të amendamentimit në Kuvend, që në fakt, janë disa detaje që ndoshta vetëm ata profesionistët mund t'i vërejnë dhe ne shpesh duhet ta kemi vëmendjen se, ta përdor një shprehje “dreqnitë mund të fshihen në detaje” dhe kjo mund të na çojë deri te minuset edhe sa i përket ecjes përpara në progresin e Kosovës lidhur me obligimet që i ka bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sali Zyba.

**SALI ZYBA:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Unë po përpiqem të shpjegoj prej vendit, sepse para vetes kam shumë dokumente. Në këtë rast kam ligje, udhëzime, por në veçanti kam raporte, si ndërkombëtare ashtu vendore që flasin për shqetësimin që ne sot kemi ftuar këtë seancë të jashtëzakonshme.

Sa u përket kolegëve parafolës që qenkan përjashtuar të iniciativa, të thirrja apo nënshkrimi për këtë seancë, të mos e marrin shqetësim këtë, por të bëhen kontributdhënës në ndryshim të këtij ligji, ose të kësaj gjendjeje.

Unë po e filloj një shpjegim detyrimisht t'i referohem Ligjit për automjete, por duke u bazuar në udhëzimin që ka dalë si derivat i ligjit të kaluar. Udhëzimi administrativ i 2008-ës, i nënshkruar nga ministri Limaj në atë kohë, i referohem sepse do ta bëj fillimisht dallimin e udhëzimit kur e ka nënshkruar zoti Limaj me udhëzimin kur tash e ka nënshkruar Palë Lekaj. Dallimi është esencial, por po e përshkruaj me një fjali. Dallimi është ky: Udhëzimi i 2008-ës është bërë për “Euro-Labin”, kompani për të cilën po flasim, ndërsa Udhëzimi i vitit 2018 është bërë nga

“Euro-Labi”, për përshtypjet e mia. Sigurisht, se do ta shpjegoj për të dytin, por për atë pararendësin po shpjegoj diçka, po veçoj të vetme dy pika.

Po e lexoj te neni 19, te revokimi i autorizimit. Këtu kontrabandohet kur thotë se “mjetet të cilat importohen në Kosovë duhet të jenë të homologuara në pajtueshmëri me dispozitën e këtij Udhëzimi administrativ, në mënyrë që mund të kalohet te Dogana”. Këtu është futur një nen në emër të një revokimi të autorizimit e ka futur një obligim, me të cilin i ka detyruar secilin importues, secilin qytetar të Kosovës që ka shkuar në procedurë të homologimit, fillimisht të bëhet homologimi e më pas doganimi, që do të duhej të ishte e kundërta, sepse njeriu mund ta doganojë, e më pas për gjendje, për kushte në rrugë, mund edhe ta homologojë. Kjo ka qenë e qëllimshme atëherë, për ta garantuar fitimin e secilës hyrje në Doganë.

Më pas e kemi nenin 20 te vërtetimi për përshtatshmërinë e mjetit individual të kontrollit apo deklaratën të përshtatshmërisë së mjetit, medoemos thuhet pikërisht te kjo, bashkëngjitet kontrolli teknik, që do të thotë se medoemos duhet bërë kontrollimi i parë kur vjen në Kosovë te ky institucion privat. Domethënë, e detyron secilin blerës që herën e parë ta bëjë këtu, ky është monopoli që e garanton qysh në start, ky udhëzim edhe ashtu për monopol të veçantë. Ndërsa, sa u përket neneve të veçanta që vejnë në kontradikta Fatmir Limajn në atë kohë, ministër, mënyrën qysh e ka bërë për përfitime edhe të vetat, po i lexoj nenet kur thotë te mbikëqyrja e zbatimit, neni 24, është mbikëqyrja e zbatimit, por neni 25 thotë kështu: “Dispozita e këtij Udhëzimi administrativ fillon të zbatohet prej 1 janarit 2009”, neni pasues dhe 26 thotë: “Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri”, e nënshkrimi i ministrit është më datë 19. 8. 2008. Domethënë, vetë nenet në radhë që janë, janë kundërthënës njëri me tjetrin. Për të kaluar te udhëzimi tjetër, në këtë rast udhëzimi i Palë Lekës, për të cilin thashë se e ka bërë “Euro-Labi”, meqë u konstatuan edhe interesat e përfaqësuesit të kësaj ministrie, në këtë rast drejtorit Nebih Shatri, në pyetje në komision më shumë se tri herë që ia parashtrova: “A ka konflikt interesit dhe a ka përfituar i njëjti?”, nuk i deklaroi përfitimet, por më pas në medie doli se ka përfituar nga ky mekanizëm privat, por në këtë rast përgjegjës është shteti.

Tash ky ekspert, në këtë rast edhe ministri, tha nuk është homologim. Çka është nëse nuk është homologim, kur udhëzimi dhe ligji paraprak i referohen si homologim. Edhe udhëzimi që vetë e ka nënshkruar ministri është homologim, prandaj këtu para se të hyj te pikat, po dua të them diçka për ministrin, ose për rrjedhën e deritashme. Nëse e marrim fjalën “homologimi i automjeteve”, homologimi, sa ka qenë fjala homologim si term, në rregull ka qenë, por kur ka filluar konkurrenca në mes dy ministrave, kanë bërë homolog “i imi – i imi” domethënë ka mbetur fjala homolog. Nëse kjo kontratë vazhdon do të mbetet vetëm “homo”. Këtu s’ka keqkuptim, por do të mbetet vetëm “homo”, që i bie doktori i deritashëm në këngën e shquar “doktor Leka, do të bëhet Homo-Leka”, Palë Lekaj në këtë rast.

Të kaloj te udhëzimi, do t'i përshkruaj disa prej neneve që janë shumë problematike. Disa që janë më pak të rëndësishme do t'i kaloj, po do të filloj me nenin 4, i cili funksionon, ose në këtë rast funksionet profesionale të subjektit të autorizuar për homologim. Këtu kemi specifika të veçanta, po kjo pason ajo që ka qenë në udhëzimin e kaluar, ku neni 1.9, kontrolli i parë i rregullsisë teknike i mjeteve rrugore e detyron prapë përfituesin e njëjtë. Më pas, neni 1.10 thotë “mund të bëjë marrëveshje bilaterale”. Ai marrëveshje mund të bëjë me dikë që nënkupton se nuk lejon të ketë konkurrencë në treg.

Po kaloj te disa nene që janë më të rëndësishme, pra neni 6 është ai përshkrimi teknik për të cilën e arsyeton atë që thashë në fillim, që ky udhëzim është bërë konkretisht nga “Euro-Labi”. Po filloj me disa përshkrime këtu që janë detaje, por janë shumë të rëndësishme, sepse e faktojnë këtë gjendje. Neni 6 thotë: “Operimi profesional i institucioneve të autorizuar të homologimit”, që fillon kështu, “Neni 1, Ministria përcakton kushtet për funksionim...” Unë këtë fjalë e them kështu, Ministria kopjon, domethënë ka kopjuar gjendjen faktike të këtij mekanizmi. Tash po i shpjegoj disa. Këtu neni 2.1 po e lexoj: “Sipërfaqe totale të hapësirës ku ofrohen shërbimi teknik i kontrollit dhe verifikimit jo më pak se 700 metra katrorë”. Kjo është gjendja faktike e “Euro-Labit”. “Zyra të mjaftueshme për administratë me sipërfaqe jo më pak se 300 metra katrorë”, këto i ka “Euro-Labi”. “Hapësirën për qëndrim, pritje të palëve, me sipërfaqe jo më pak se 100 metra katrorë”, këto i ka “Euro-Labi”.

Kemi vendparkimet për pjesën e përshkruar teknike që deri në 3,5 tonë, ku thotë se duhet t'i ketë 150 vendparkime. Këto vendparkime i ka “Euro-Labi”. Më pas e kemi edhe parkingun për mjete të mëdha dhe më pas hapësirën për arkivim të dosjeve prej 200 metrash katrorë, edhe këtë çuditërisht e ka “Euro-Labi”. Disponojnë me minimumin në pjesën... po lexoj edhe diçka tjetër, te kushtet e disa prej pajisjeve, ndërsa sa u përket kategorive të kontrollit dhe inspektimit, po veçoj te këto 3,5 tonë, e kemi gjatësinë e kanalit, kuptohet 8 metra, se në të kundërtën nuk ka funksion, sepse edhe e ka, ashtu-ashtu, po i kemi te përshkrimet e tjera teknike.

Pajisjet për gazra, do të veçoj diçka, janë një kopjim i gjendjes te këto. Te pajisjet për ventilim të gazrave, ato kapacitete që i ka tashmë “Euro-Labi” kërkohen me Udhëzim administrativ. Këto janë arsytet që po i përmend gjithmonë, kur thotë te i njëjti nen 3.1, do të thotë, duhet të ketë personel drejtues, menaxhues, me shkollim të lartë teknik minimal master, përvojë pune më shumë se 5-vjeçare në fushën përkatëse. Meqenëse ka qenë i vetmi, kush tjetër mund t'i bëjë konkurrencë në Kosovë me këtë përshkrim pesëvjeçar. Ne edhe fakultetin ashtu e kemi trevjeçar e katërvjeçar, ndërsa përvoja teknike e një inxhinieri tashmë të kualifikuar i kërkohet një përvojë pesëvjeçare, për të cilën e ka i vetmi EuroLabi.

Të posedojë ankesë në IST bazën e të dhënave. Këto të dhëna nuk varen te ai, po meqenëse i ka të siguruar tashmë, ashtu ia njej Ministria.

Krijimin e dosjeve që e ka, atë duhet pasur, e ka vetëm ky.

Tash kemi një pikë tjetër të neni 7. I referohem veç pjesës së fundit, pikës së parë, ku thotë kapacitetet hapësinore kadrovike dhe e materialeve teknike. Shkojmë te neni 2, thotë studimin e fizibilitetit nga paragrafi 1 i këtij neni, e realizon subjekti i shpallur fitues nga aktiviteti konkurrues sipas Ligjit për prokurim publik, për të cilin tash e dimë më sesi ka ndodhur, apo s'ka ndodhur fare, të them më mirë.

Pika 3 thotë, vlerësimi për nevojën për autorizim të subjektit për homologim, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i paraprin matja e kapaciteteve të shfrytëzimit tekniko-shërbyese, mesatare për tre vjetët e fundit. Kush ka punuar tre vjetët e fundit? Në këtë rast, "Euro-Labi", jo tjetërkush.

Te përçindja, meqenëse tha Glauku, nuk po ndalem te monopoli mbi 85 për qind. Këtë shqetësim e kanë thënë edhe profesorët e Fakultetit Teknik. Te subjekti, këtu tash këtë kualifikim e kemi: subjekti i ngarkuar me studimin e fizibilitetit. Kush është? Në këtë rast i bie "Euro-Labi".

Edhe te pika 5, thotë: pas plotësimit të kushteve nga paragrafët e mëparshëm, në këtë rast numri 4, thotë Ministria mund të shpallë, jo mund po duhet, se kjo mund e lë mundësinë e këtij ministri aktual, i cili veç është deklaruar se nuk do ta ndalë këtë monopol.

Subjekti që lëshon pëlqimin obligohet që brenda një viti t'i plotësojë të gjitha kushtet e parapara me ligj, e që në këtë rast, "Euro-Labi" veç i ka plotësuar, po nuk duhet të jetë një vit, sepse ai operon. Një vit është shumë.

Pika nën 10 thotë: Komisioni i emëruar nga ministri e bën verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar, nëse Komisioni konstaton. Këtë Komision, këto procedura, tashmë u kuptua përmes zyrtarit në këtë ministri, që i njëjti ka përfituar kundërligjshëm dhe ka konflikt të interesit.

Te pika 13, thotë: subjekti që i plotëson kushtet për licencim sipas nenit 6 të këtij udhëzimi administrativ, ministri i lëshon licencën në afat të pakufizuar.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kaq patët kohën. Me lejen tuaj, po u jap fjalën deputetit Islam Pacolli, se paska një detyrim, pastaj vazhdojmë sipas radhës. Urdhëro, Islam!

**ISLAM PACOLLI:** Faleminderit kryesues!

Faleminderit për mirëkuptim, ju përsëndes të gjithë,

Me të vërtetë ne jemi tani një shtet demokratik dhe duhet pasur demokraci dhe një veprim. Monopoli nuk është i mirë, nuk i shërben qytetarit. Qytetarët po të jenë të vetëdijesuar është dashur kaherë të ndërrojnë ose monopolin, ose Qeverinë, për arsye që kjo është direkt në koston

e qytetarëve, jo në koston direkt të Qeverisë. Prandaj, qytetarët duhet të jenë të vetëdijesuar, mos të aprovojnë një gjë të tillë.

Sot ne e kemi një monopol, ku ne i qesim homologim edhe atij prodhuesit të makinave që prodhon makina për tërë botën, në këtë rast që është Gjermania dhe shumë shtete të tjera, që i kanë cilësinë maksimale që s'e ka askush tjetër. Edhe ne i qesim homologim. Kjo është e padrejtë. Nuk mund të ketë homologim para se ta kenë në përdorim një veturë e re njëvjeçare. Kjo nuk bëhet as në perëndim. Po bëhet vetëm te ne. Mendoj që është drejtpërdrejt një inkasim të hollave të qytetarëve padrejtësisht.

E dyta. Unë kërkoj rreptësisht që të ndalet monopoli. Por sigurisht që të gjitha ato kompani që i plotësojnë kushtet që janë me standarde normale të vazhdojnë, edhe të konkurrojnë dhe të shkojnë përpara.

E treta. Si mund të jenë në këto udhëzime administrative, ku bëhet homologimi i një veture vetëm pse ndërrohet pronari, ne duhet të bëjmë edhe një herë homologimin. Është e padrejtë. Homologimi vlen një vit dhe kjo minimumi do të jetë për ata. Edhe pse ndërrohet pronari, nuk duhet të jetë e detyrueshme homologimi për së dyti. Prandaj, edhe këtu është një lloj plaçkitje e xhepit të qytetarëve, prandaj kërkoj që kjo të shqyrtohet dhe të bëhen këto ndryshime. Të hiqet monopoli gjithsesi dhe mendoj që edhe kolegët i përmendën shumë pika që janë të rëndësishme, t'i marrim parasysh dhe ne të mos thirrremi në emër kush është atje, po ne të veprojmë si ligjvënës dhe Qeveria duhet të jetë e barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit kryesues!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ia jap fjalën për një replikë deputetit Bilall Sherifi, në emër të grupit parlamentar. Dy minuta!

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit kryetar!

Meqë u apostrofua kryetari i partisë sime, unë kam të drejtë në replikë. Tash kolegut në fjalë, dy fjali të shkurtra. Analiza që i bëri udhëzimit...

**KRYESUESI:** Cilit, Bilall? Cilit koleg?

**BILALL SHERIFI:** Kolegu paraparak i Vetëvendosjes. E di ai. Që i bëri një analizë udhëzimit të 2008-ës. Dy fjali të shkurtra i kam për të.

E para, analiza tregon se s'ka lidhje me këtë temë, ndërsa shpifja që bëri me atë fjalinë se e paska bërë për përfitime personale, e bën shpifës, të certifikuar madje, të homologuar. Sepse pa asnjë provë, ta shpallësh dikë që ka bërë për përfitime personale, e ka homologuar vetveten, e ka certifikuar si shpifës 'par excellence'. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Sali Zyba, kundër-replikë, një minutë.

SALI ZYBA: Faleminderit Bilall për mundësinë të vazhdoj edhe pak se ashtu m'u ndal fjala.

Nëse merret lista e të punësuarve në këtë mekanizëm që s'po mund t'i them, se nuk është i shtetit, po i shtetit të kapur nga persona që tashmë janë bërë më shtet se shteti, aty e sheh se kush është përfitues i këtyre. Në kohën kur është dhënë, mënyrën qysh është dhënë, nuk ka tjetërsend. Këtë kualifikimin që ma bën ti mua, i homologuar, tashmë nëse i kemi faktet për bazë mund të jetë edhe ashtu, po të lutem për gjendjen, ky objekt për mua është prej kur është krijuar, me vete kam edhe fotografitë kur nuk ka ekzistuar fare, edhe kur është dhënë, edhe kur është në procedurë. Këtu dihet botërisht kush është përfituesi. Është Fatmir Limaj për të cilin. Dëshmi? Atëherë do të ballafaqohemi në ditët në vijim. Këtu është momenti kur ne, është momenti kur ne do të ballafaqohemi me gjendjen që do të vazhdohet kontrata. Është rreziku edhe dhjetë vjet të tjera t'i jepet. Kush është përfituesi? Fatmir Limaj ka qenë ministër dhe...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetit Daut Haradinajt. S'është në sallë. Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

KRYESUESI: Mund të vazhdoni zonja deputete!

TEUTA HAXHIU: Po! Duke parë...

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, ju lutem që të krijoni kushte që mund të vazhdojë deputetja. E keni fjalën, mund të vazhdoni, Teuta!

TEUTA HAXHIU: Megjithatë, pra seanca e thirrur sot. Ne jemi mësuar me një zhurmë, po duhet të më krijohen kushte të marrë fjalën, nënkryetar. E di që e respektoni rregulloren.

KRYESUESI: Kolegë, ju lutem që të mundësoni koleges të vazhdojë fjalën, sepse ka të drejtë. Ju folët. Vazhdoni!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar!

Sinqerisht, meqë...

KRYESUESI: Bilall, pas Teutës mund ta merrni fjalën. Vazhdoni, Teutë!

TEUTA HAXHIU: Unë punën e deputetit e shoh dhe jam duke u munduar ta gjej edhe në Rregullore, se ku është e bazuar puna e deputetit dhe cilat janë angazhimet, po nuk po mund ta gjejë atë që po ndodhë në seancat e jashtëzakonshme.

Tani në këtë seancë, si joprofesioniste, sepse ka të tillë që janë të gjithëdijsëm, po unë nuk e gjithëdijshe dhe nuk pretendoj, po e zotëroj një fushë. Sepse të gjithë ata që mendojnë që dinë shumë, nuk dinë bash kurrëgjë. Dhe u mundova të kuptoj me atë joporfesionalizëm, se në fund të fundit nuk jam e fushës, dhe është krejt normale ta kuptosh jo çështjen, sepse sinqerisht prej fillimit të mandatit të parë, që është për mua mandati i tretë, ka pasur edhe iniciativa në këtë Kuvend për monopole të ndryshme, kur janë kërkuar përgjegjësitë. Deputetë të guximshëm, por kanë qenë shumë konkretë, me emra, me mbiemra, u janë drejtuar minsitreve, ministrave dhe kanë kërkuar përgjegjësi.

Tani më shprehia për të folur shumë, e të mos thuash asgjë, dhe për të folur e mos të qëndruar në fjalën e vet, nuk është në etikën e deputetit, nuk duhet.

Atëherë, puna e deputetëve është nëpër komisionet funksionale. Secili anëtar, secili deputet, pos që ka një fushëveprimtari në komisionin funksional, e ka të drejtën të marrë pjesë edhe në secilin komision tjetër. Por, tani nga fjala e ish-ministrit Zharku të cilin me vëmendje e dëgjova, ngase ne jemi në një gjendje, gjë që nuk është e mirë. d.m.th. a ka monopol? Po! A duhet të ndryshojë gjendja? Po! Kush e ndryshon gjendjen? Fjalët? Sa herë ju konvenon të nderuar kolegë, thoni e kam rastin konkret, një rezolutë të cilën e pres prej nëntorit të vitit të kaluar për pensionistët kontributdhënës dhe më thoni, unë kërkoj ndryshimin e rezolutës, ju më thoni jo s'bën rezolutën se është derivat i ligjeve, duhet të ndryshohet ligji. Atëherë, ligjet nuk lexohen një nen po, një nen jo. Të gjitha rezolutat, të gjitha udhëzimet administrative janë derivate të ligjeve. Atëherë, nëse doni të kryeni punë, ejani të punojmë, 110 deputetë jemi, duke i parë edhe shumë mbështetës të fuqishëm profesionistë nëpër komisione, për një periudhë shumë të shkurtër kohore, e ndryshojmë ligjin. Ju keni sjellë një vendim tani me tri pika, në të cilin pra thuhet, ndryshimi i udhëzimit, i udhëzimit në një afat, udhëzimi. Pra, kur dikujt po i konvenon dhe po kërkoj me urgjencë ndryshim të një çështjeje, mua po më thoni nuk bën, sepse udhëzimet administrative duhet të ndryshohen nga Qeveria.

Atëherë, edhe një herë, ligji është abc-ja. Kuvendi funksionon edhe shteti në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve. Dhe secili, secili nuk është që mund ta dijë secilin akt nënligjor nga ka dalë. Pra, për të hequr monopolin, që po ekziston, fatkeqësisht ekziston, deh derivat i kujt më, unë nuk kam nevojë ta them sepse dihet, por a po duam të kryejmë punë? E unë këtu nuk po shoh që po kryhet punë. Po shoh një joseriozitet. Po i kthehem fjalës së parë të cilën vërtet u mundova ta kuptoj zoti Zharku. Zoti Zharku a jeni ju si ish-ministër dhe si profesionist anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik? A jeni anëtar? Pres përgjigje! A keni qenë në mbledhjen e thirrur nga Komisioni ku prezent ka qenë ministri Lekaj? Megjithatë, unë po e lë në ndërgjegjen e secilit. Është ministër,

kujtdo që i pëlqen apo nuk i pëlqen, mund ta thërrasë qysh të do, po megjithatë e udhëheq një ministri. A keni qenë? Pse nuk keni qenë? Pse keni ikur? Pse nuk keni shkuar të ballafaqoheni aty? Sot, nuk është mirë që nuk është Qeveria këtu, por e përmendi nënkryetari, ka një shkresë zyrtare të ministrit, i cili nuk është në Kosovë. Pra, ju nuk keni qenë, nuk keni shkuar të ballafaqoheni, sado... Jo ka lidhje, sepse këtë e keni krijuar ju dhe sa herë ju ka konvnuar, në atë kohë keni lënë të notojë kush ka dashur, kur s'të ka konvnuar atëherë ke marrë një vendim.

Prandaj është përgjegjësi totale, i papërgjegjshëm, shumë i papërgjegjshëm, përderisa nuk ke shkuar në Komision të ballafaqohesh si ish-ministër. E aq më tepër edhe si anëtar i Komisionit. Por, si një ish-ministër, kjo është papërgjegjësi totale. Unë këtë nuk e kuptoj. Nuk është në etikën, nuk duhet të jetë në etikën e një deputeti profesionist e si ish-ministër. Prandaj, në fjalën e juaj, ju me atë butësinë, jo me butësinë deri sot i keni kryer punët brenda mandatit që e keni pasur. Ju po ju citoj, sepse e tha: jemi përpjekur në mënyrë paqësore ta tejkalojmë. Saktë të gjitha të tjerat nuk arrita, por në mënyrë paqësore. Jo more kur je ministër, nuk ka mënyrë paqësore, kryej, merr vendime të guximshme që janë në interes të qytetarëve. S'ke marrë asnjë hap, por gjithçka ke mbjellë keq, edhe nuk ballafaqohesh çka është më e keqja. Nuk ballafaqohesh në një Komision profesionist ku je i thirrur, je më se i thirrur. Ajo është detyra e deputetit. Ke ikur dhe kjo është përgjegjësi totale e papërgjegjshme dhe jollogaridhënëse. Duhet dhënë llogari dikujt që ta ka sjellë deri këtu. Pra duke qenë edhe ministër, si ish-ministër, po edhe si anëtar. Pra, nuk ka mënyrë paqësore derisa të rregullohen çështjet me interesa të individit apo të grupeve të caktuara, kujtdo qofshin, në cilëndo ministri. Kështu nuk udhëhiqet asnjë ministri, nuk do të duhej të udhëhiqej asnjë ministri. Nuk do të duhej të lejohej rruga për t'u bërë monopole të tilla, po nëse doni t'i ndërpritni për të mos shkuar kështu në mënyrë paqësore siç zoti Zharku ka shkuar, po duhet marrë vendime.

Dhe unë po ju them edhe një herë. Ky vendim që e keni shkruar nuk zgjidh punë. Ne jemi dëshmitarë, do të shohim, nuk keni për ta kryer, dhe nuk jeni të interesuar për mua ta zgjidhni. Nuk jeni të interesuar ta hiqni monopolin, ju që e keni thirrur këtë seancë, fare s'jeni të interesuar. Nëse jeni të interesuar, sot po i mbledhim nënshkrimet, po fillojmë punën për ndryshimin e ligjit. Jo të ligjit, se nuk e di sakë cilit, sepse u përmend ligji 054/182 i vitit 2017, po edhe ligjet e tjera, se i përmendi një koleg edhe disa ligje të tjera, mundemi secili komision. Thash edhe një herë ka mbështetje prej shumë organizatave që na mbështesin, për të përshpejtuar dhe për të qenë shumë të saktë, sepse mund të jemi shumë që nuk jemi të fushës dhe jam shumë interesuar, por edhe një herë mos tentoni vetëm sa për të folur. Fatkeqësisht edhe kjo seancë do të shkojë kështu. Nëse doni të preni, të rregulloni këtë çështje, të hiqni monopolin, të hiqni brengën dhe barrën që e kanë qytetarët, qytetarët në fund të fundit, sepse një koleg tha i qesim homologim Gjermanisë e Zvicrës, jo. Shteteve nuk ju qesim homologim ne as Gjermanisë, as Zvicrës, po qytetarëve tanë, që i sjellin makinat prej atje dhe të reja, por edhe ndër vite dhe ata menjëherë pas të gjitha kontrolleve që bëhen në ato shtete, se nuk bëhen rastësisht, ne menjëherë ju qesim këtu.

Por, po e lëmë pjesën sesi ka ardhur deri këtu. Gjatë, gjatë është. Po a po doni ta ndalni? Jo, nuk jeni duke dashur ta ndalni. Hajde të punojmë ta ndalim. Jo nuk për të folur, ndaleni ju. Hajde nëse doni të kryeni punë, jemi deputetë, jemi të obliguar të kryejmë d.m.th. çdo shqetësim të ngritur prej një qytetari, e lëre më prej interesit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Shefi i GP të Nismës, Bilall Sherifi, dy minuta!

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Ajo që desha të them është që Kodi i mirësjelljes edhe i deputetëve, edhe i gjithë atyre që e merr fjalën, kërkon që këtu të flitet me fakte, me prova dhe jo të flitet me insinuata. Jo perceptcionin tënd ta sjellësh këtu në foltore. Ky është shqetësimi im.

Kushtetuta jonë parashih disa shkallë derisa dikush të shpallet kriminel. Nuk e ka këtu licencën askush për të shpallur askënd kriminelë. Pra, nga hetuesia, policia, gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë, gjykata e shkallës së tretë, të gjitha këto duhet të kalojnë nëpër të gjitha këto hallka, një person për ta shpallur kriminel ose të lirë. Këtu e kanë lëshuar gojën lirë ta shpallin kriminel, mafiozë, hajna, njerëzit pa asnjë provë. Edhe qetë-qetë vazhdon shkon në shtëpi, shkon në lagje, shkon në rrethin e tij, thotë a ua bëra mirë. Pra, pak rëndësi ka a e ka thënë të vërtetën, pak rëndësi a ka sjellë prova aty, rëndësi ka që të kënaq veten edhe militantët. Ama, unë mendoj që kushdo që është në krye të seancës, në kryesim të seancës, duhet të fillojë të zbatojë këtë standard të etikës dhe të mos lejojë as mua, dhe askënd, asnjë deputet, as kryetarin që të shpallë djathtas, majtas askënd kriminel. Kushdo që ka prova, duhet të shkojë atje ku duhet të deponohen provat kush ka bërë veprime shtetërore për përfitime personale, kush ka bërë hajni, kush ka bërë vjedhje, atje duhet të shkojë. Jashtë Parlamentit, nëpër tubimet e tyre le të thonë çka të duan, ua garanton liria e shprehjes, po jo në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Këtu do të duhej të ndërtonim në standard për të cilin, edhe të cilin t'ua lëmë trashëgimi edhe deputetëve të tjerë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Sali Zyba, një minutë kundër-replikë! Enver, dy nga i njëjti grup s'kam të drejtë t'jua jap fjalën.

**SALI ZYBA:** Faleminderit, kryesues!

Unë me të vërtet kur ta kryej fjalimin edhe seancën shkoj në shtëpi, po jo në negociata të kundërligjshme, kundërkushtetuese sikur shefi yt, lirisht shkelës i shumë ligjeve, procedurave. Kije parasysh, unë iu referova një udhëzimi që e ka shkelur edhe ka qenë kontradiktore në nenet secilin. Sa i përket gjendjes faktike të ndërmarrjes, i kam dy fotografi ku ilustronë para se të merren disa vendime, dhe kur ka marrë vendime, sesi objekti ka përfituar miliona që u përmendën nga kolegët e tjerë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka sipas radhës deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë sinqerisht habitem qysh ministrat e tanishëm, ministrat e kaluar, kryeministrat nuk e lexojnë biografinë e kryeministrit kroat Sanaderit, që e kanë lidhur si qenin prej Austrisë dhe e kanë sjellë në burg dhe e kanë lidhur dje si qenin atë...

KRYESUESI: Regjia ju lutem! Regjia, ju lutem mbylleni mikrofonin!

Milaim, ju lutem duhet të respektoni kodin e komunikimit. Mund të vazhdoni. Askujt s'mund t'i drejtohem në atë mënyrë.

MILAIM ZEKA: S'iu drejtova kolegëve...

KRYESUESI: Mund të vazhdoni. Askujt Milaim. As njerëzve që s'janë këtu.

MILAIM ZEKA: Në rregull! Kërkoj falje!

Atëherë duhet lexuar për Gruevskin që e kanë lidhur dje dhe kanë për ta sjellë në burg në Shkup. Tani çka ndodh këtu me deputetë, këtu ka plot deputetë në mesin tonë që e dinë biografinë e vet personale, me kë janë të lidhur, kah janë të lidhur dhe nuk frikësohet askush në këtë shtet, sepse këtu e kam thënë dhe po e ripërsëris nuk ka kryeprokuror.

Ky vend nuk ka kryeprokuror. Ne i marrim vendimet në panik. Ne e sollëm një ligj për dialog dhe u pa që ligji është antikushtetues dhe kurrkush nuk shqetësohet hiq. U shkel Kushtetuta, punë e madhe. Pse? Se nuk ka kryeprokuror, se po të kishte kryeprokuror që edhe Donald Trump i tutet prokurorit të shtetit, edhe Merkel i tutet prokurorit të shtetit, edhe dridhet çka po bën e çka po vepron, ky vend do të ishte krejt ndryshe.

Tani po kaloj te miku im, te Lutfi Zharku. Vetëvendosjen e kuptoj në mënyrë absolute, çdo gjë e pranoj çka flet, çka diskuton. Po këta që kanë qenë pjesë të Qeverive. Kush e ka penguar Lutfi Zhrakun ta shfuqizojë atë urdhrin administrativ për homologim? Askush. Kush e ka penguar? Askush. Le të më tregojë zoti Zharku, kur erdhi ministër në Infrastrukturë, pse nuk doli të tregojë pse u ndryshua traseja e autostradës? Sepse këta e ndryshuan vetë trasenë e autostradës për Kaçanik, se së pari bëhet blerja e tokave, pastaj shpronësimi i tokave. Më së pari e blej unë tokën, pastaj e shpronësoj, ia fus rrugën andej, edhe prej 100 euro, e bëj arin, një ar tokë, e bëj 1000 euro.

Homologimi, të gjithë e dimë që ka qenë plaçkë. Qe dhjetë vjet është plaçkitur populli. Tash kemi për ta ndryshuar sot, po ku është përgjegjësia? Kush po shkon në burg? Ne kemi plot monopole këtu. E kemi monopolin e rrymës. Kush e blen rrymën në Kosovë? Pse është vetëm një kompani për blerjen e rrymës? Sepse janë politikanët të fshehur prapa saj. Dhe po të kishte

prokuror, sot e arreston Ahmet Isufin, se Ahmet Isufi tha në këtë foltore pse po fshiheni, a tha kështu? Pse po fshiheni tha, pse s'po tregoni kush janë politikanët prapa homologimit? D.m.th. Ahmeti e di, e nuk po kallëzon. Pse nuk po tregojnë që ministritë tona janë për ta shkatërruar biznesin privat, ta bllokojnë investimin e mërgatës shqiptare këtu. Unë po jua jap një shembull me emër dhe mbiemër. Një biznesmen i quajtur Sabri Novosella, pronar i "Nënës Naile ka kërkuar që ta ndërtojë në Brezovicë një hotel të jashtëzakonshëm me pese yje. Ministria e Ambientit, fillimisht ia ka kërkuar ryshfet 800 mijë euro, pastaj kanë zbritur në 600 mijë dhe dy banesa në Prishtinë.

600 mijë euro, plus i kanë thënë dy banesa, se banesat në Brezovicë do t'i merrnim po pak si vështirë për t'i shitur. Urdhëro? Nga Ministria e Ambientit. Nga kush, le të shkojë prokurori dhe le ta marrë në pyetje Sabri Novosellën.

Urdhëro? Jo, jo, unë Ahmetin s'e çojnë në burg, e as ty Muharrem, mos u bë merak. Hiç mos u bë, se këtu në burg e çojnë, kujt ia fut ai portali i nëntokës. Mundet të shkojë njeriu në burg, veç nëse i teket Insajderit serb në gjuhën shqipe, që ta shkruaj një shkrim për dikë, veç kur ta shikosh të lidhur.

Ky është shtet që përnjëmend po them, nuk e di se kush kishte mundur që ta bënte kaq kaçamak.

Tani po kthehem diku tjetër. Pse nuk po funksionon shteti? Pse nuk funksionin shteti? Dhe këtë e kam këshillë për ata që do të vijnë në pushtetin e ardhshëm. Kurr[ s'do të ketë Kosova shtet pa i ndërruar sekretarët permanentë.

Ore, ku keni parë ju qeveri evropiane, kur vjen ministri e nuk e ndërron sekretarin permanent. Po ata janë hajnat më të mëdhenj të këtij shteti. Sekretarët permanentë, drejtorët e prokurimit, të cilët krejt e bëjnë me miratimin gojor të ministrave.

Pse po bëhen këta kaq të mirë? Pse po bëhen sekretarët kaq të mirë? Sepse janë njësoj sikurse ata biznesmenët e Sali Berishës në Shqipëri, që si ka ardhur Edi Rama në pushtet, menjëherë janë bërë me të.

Pse nuk po flasim për çmimin e naftës në Kosovë? Po a e dini ju që çmimi i naftës e i benzinës në Kosovës është më i lartë sesa në Gjermani. Bëhej ulja e çmimeve të derivateve në krejt botën, në Kosovë shkonte përpjetë. Kjo, sepse janë të përzier krerët politikë.

Po ua bëj një pyetje, pyetini një ditë kryeministrin kur të vjen këtu. Pse nuk u ndërrua asnjëherë në Qeverinë e Kosovës, shefi i transportit. As nuk ia di emrin, as nuk ia di mbiemrin. Mund të jetë tezak apo dajë imi, i familjes, unë nuk ia di, por ia di funksionin e tij.

Ndryshe, edhe grave të ministrave ua ka mbushur kerret me benzinë dhe me naftë. Pastaj, ai ua nënshkruan ministrave kur enden lidhje e palidhje e në këtë Kosovën që është sa gogla. I shkruajnë për gjashtë muaj, nga 200 mijë kilometra udhëtime.

Domethënë, ky shefi i transportit, ky jo që nuk ndërrohet, por nuk guxojnë ta rrëzojnë se ky pastaj thotë se unë dal e kallëzoi për ty. Këtu u bë matematika fol-fol ti për mua, po nëse unë tregoj për ti, ti e hanë edhe më keq.

Çfarë të bëjmë që ministrat tanë u frikësohen edhe shoferëve të ve. I tute edhe shoferit se shoferi ia di 100 skandale. Prandaj, ky shtet nuk funksionin. Nuk funksionon. Nuk ka për të funksionuar.

Nuk kemi ne moral politik, njerëzor dhe të çohemi e të themi, një njeri brenda LDK-së, një njeri brenda PDK-së, një njeri brenda cilësdo politike. Këtë e këtë e këtë e kemi bërë mirë, po këtu e këtu e këtu e kemi bërë bërlllok.

Ore, të gjithë e dinë që homologimi ka qenë plaçkë absolute. Nëse e pyesni dikë në rrugë, e di. Të vjen makina e re prej fabrikës, e të futet në homologim. Po a e dini ju që halle hala më të mëdha se homologimi ka qytetari i Republikës së Kosovë, ku në çdo vend evropian, regjistrimi, vazhdimi i regjistrimit të makinës bëhet çdo dy vjet dhe me një kamion dokumente.

Në çdo vend evropian, të shkosh për ta vazhduar pasaportën e vazhdon vetëm me një dokument paraprak, ai është pasaporta jote e vjetër. Vetëm ta shpon pasaportën edhe ta jep pasaportën e ri.

Po a dini more që i shkokërdhuam qytetarët. I shkokërdhuam more qytetarët, me një letërnjoftim me ndreq dy javë ditë. Me regjistrimin e djalit, tri javë ditë. Me vazhdimin e librezës së makinës, dy javë ditë. A po e shihni more se i mbytëm këta njerëz.

Prandaj, ja Lutë se erdhe tani, desha ta di se a është ndryshuar traseja e rrugës për Kaçanik, e para dhe e dyta, pyetja ime ishte këtu; pse nuk e ke zhduk homologimin? Pse nuk e ke shfuqizuar homologimin? Këto pyetje po jua drejtoj juve.

Po të isha ministër, si do të isha hyrë në zyre, mirëpo me qenë ministër që nuk jam i kapt dika, veç kështu ia kisha bërë, ti a? Po. Unë ta shfuqizoj. Hajt ju shkoni dhe pyesni sekretarët permanente se çfarë ka bërë ai ministri paraprak çka ka vjedh? Jo, vallahi, s'guxoj me të tregu.

I njëjti sistem është në Post-Telekom të Kosovës sot. I njëjti sistem është në KEK. Çdo gjë në Kosovë është monopol. Zoti shyqyr, po e përfundoj këtë fjalim timin, që gratë i kemi të regjistruara në emrin tonë, se edhe gratë do të na i monopolizonin.

Veç edhe këtë që s'e kanë bërë.

KRYESUESI: Faleminderit! Po, Muharrem ke të drejtë. Replikë, dy minuta. Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: I nderuari, nënkryetar edhe kolegë Zeka. Unë fola nga foltorja meqenëse Miliami e përmendi kolegun Ahmet Isufi edhe besoj me të drejtë. Mirëpo, e bëri të njëjtin gabim edhe vet.

Është akuzë e jashtëzakonshme kur një deputet në foltoren e Kuvendit të Kosovës, thotë se Ministria e Ambientit i ka kërkuar 800 mijë euro një personi konkret dhe më pastaj e ka zbritur këtë në 600 mijë euro.

Prandaj, unë i kërkova që ta sqaronte kolegu Zeka. A e ka denoncuar personi i caktuar ministrinë? Nga e keni marrë ju këtë informacion? Dhe nëse është i saktë informacioni Miliam, pse nuk e ke denoncuar në prokurori?

Mendoj që nëse Ahmeti e bëri një gabim edhe ju e bëtë të njëjtin gabim.

Jo, jo nuk e kam problemin aty, po akuza kur është kaq e rëndë edhe kur i drejtohet një ministrie që e ka një titullar, mendoj që duhet të konkretizohet, sepse nuk ka asnjë kuptim që të nxjerrim informacione të kësaj natyre edhe të mos shkojmë tutje.

Unë nuk paskam shumë kohë, po e kemi vendimin përpara. Kërkohet menjëherë shfuqizimi i urdhrin administrativ. A mund ta bëjë Kuvendi i Kosovës këtë? Kam përshtypjen që jo. Ndoshta mund t'i sugjerohet ose t'i kërkohet ministrit.

Në një afat prej dy muajsh kërkohet të miratohet udhëzimi i ri administrativ, i cili duhet të jetë, thuhet në përputhje me Ligjin e Automjeteve dhe me Ligjin e Konkurrencës, dhe më pastaj thuhet edhe me rekomandimet e Zyrës së Bashkimit Evropian. Çka ndodhë nëse rekomandimet e Zyrës së Bashkimit Evropian janë në kundërshtim me ligjin? Mendoj se duhet të hiqen.

Ndoshta e vetmja pikë që duhet të mbetet është që në një afat prej gjashtë muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi, të liberalizohet plotësisht tregu. Më shkoi koha.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Milaim Zeka kundër-replikë. Një minutë.

MILAIM ZEKA: Unë prej që jam deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, kurrë nuk kam “vringllatë” dhe as nuk kam “shllajfitë” kur kam folur. Jam i vetmi deputet që kam folur edhe flas me emra dhe mbiemra me fakte pa e fyer askënd.



Ahmet Isufi është nga njerëzit më të ndershëm që i njoh në jetën time. Thash bëni gabim atje qysh bëra edhe unë. Mirëpo, unë kallëzoja me emër e mbiemër, dhe informacionin e kam marr drejtpërdrejtë nga Sabri Novosella.

Njerëzit kanë frikë të shkojnë të denoncojnë, sepse ne kemi prokurori që qysh e kam denoncuar unë rastin, mua m'i kanë vënë prangat. Edhe nëse shkon Sabri Novosella e denoncon edhe ia vënë prangat.

Prandaj, i nderuari Muharrem Nitaj, këtu është problemi. Pra, këtu nuk ka shtet ligjor. Këtu është shteti xhungë, që një kryeprokuror që është vendosur atje, punon për individë të caktuar, e ai është Aleksandër Lumezi.

KRYESUESI: Jo, Muharrem s'keni të drejtë. Po me këtë të drejtë që e keni, në shumë pika e tejkalonin debatin, dhe atë që lejohet të thuhet në seancë. Kështu që, unë do t'ju kërkoj që të jeni pak më të kujdesshëm, në mënyrë që edhe mua të ma bëni pak më të lehtë që ta drejtoj këtë seancë.

Deputeti Lutfi Zharku ka kërkuar dy minuta replikë.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar! Në fund do t'i jap disa përgjigje më të gjata, megjithatë vetëm për Milaimin shkurt.

E para, Milaimi duhet të pyes pse është nënshkruar homologimi dhe jo pse nuk është shfuqizuar. Pra, duhet të kthehet pak më herët. Edhe për kolegen Haxhiu, në realitet pse s'kam shkuar...Nuk besoj që duhet të jap përgjigje se pse s'kam qenë në mbledhje të komisionit, por ia bëj me dije se e kam vendosur që të mos debatoj me njerëz që nuk kanë kredibilitet.

Tjetra, mënyra paqësore, nuk e thashë kolege Haxhiu, mënyra paqësore, por e thashë mënyrë miqësore. Të gjithë ata që e dinë formulimin e kontratave apo marrëveshjen, në fund shkruhet; që çdo mosmarrëveshje zgjidhet në mënyrë miqësore, përndryshe vazhdohet në gjykatat kompetente.

Prandaj, si anëtar i qeverisë jam munduar që atë që çështje ta zgjidhi në mënyrë miqësore, ashtu siç i ka hije një ministri, një qeverie serioze. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kthehem radhës së deputetëve. Fjalën e ka deputetja, Vjosa Osmani-Sadriu.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Natyrisht që kjo çështje në masë të madhe u tentuar që të shndërrohet në çështje teknike të interpretimit të disa akteve ligjore nënligjore, por dihet fare mirë se tentime për krijim të monopoleve në fusha të ndryshme ka pasur edhe përtej homologimit.

Pra, për një periudhë të caktuar ka pasur tentime që të krijohet monopol në industrinë e mishit. Të krijohet monopol në industri të caktuara. Në disa raste ato janë ndaluar, kurse në disa raste të caktuara, fatkeqësisht për interesa të caktuara, qoftë të individëve, qoftë të grupacioneve dhe janë lejuar.

E tillë është edhe kjo kontratë, që po quhet me homologimin. Mirëpo, çështja e parë që duhet të sqarohet është se çka ka ndodhur në vitin 2008. Në fakt nuk është kontratë.

Është një marrëveshje mirëkuptimi e cila dallon nga kontrata dhe si e tillë, duhet të trajtohet përkundër faktit që ajo marrëveshje mirëkuptimi dhe udhëzimet administrative që kanë pasuar për ta mbajtur atë fuqi, përfshirë edhe këtë të fundit të ministrit Lekaj, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, por edhe në kundërshtim me ligjet.

Po e sqaroj pse. Kur është hartuar Kushtetuta e Kosovës dhe këtë mund ta gjeni qysh në parimet themelore të saj, është thënë që bazohet në disa vlera që ndër të tjera përfshinë edhe ekonominë e tregut. E përfshinë edhe barazinë të gjithëve para ligjit. E përfshinë edhe konkurrencën e lirë.

Kjo është fortifikuar pastaj në nenin 119 që u përmend, duke mos lejuar monopole. Duke i lejuar bizneset që të operojnë të lira të lira brenda parimeve të ekonomisë së tregut, përveç në qoftë se ligji e lejon në mënyrë eksplicite. Po e përsëris, në mënyrë eksplicite.

Pse, pra ky formulimin; lejimi nga ligji në mënyrë eksplicite, përjashton të gjitha ato hutitë që sot u tentuan të krijohen duke u përmendur, qoftë Ligji për Automjete, qoftë ligjet e tjera.

Unë i shikova me vëmendje nenet prej 30 deri 35 e tutje të Ligjit për Automjete që u përmenden dhe që në të gjitha sqarohet që flitet për subjektet, në shumës, për subjektet e homologimit.

Vetëm një resat, në nenin 35 thuhet; në qoftë se një subjekt i plotëson kriteret atëherë ndodh kjo, kjo, kjo dhe pastaj pasohet nga fjalia vijuese ku thuhet se, të gjitha subjektet duhet t'i plotësojnë ato në mënyrë që ofrojnë shërbime të caktuara.

Por, ta zëmë edhe sikur ajo huti ose paqartësi vërtetë ekzistonte në Ligjin për Automjete, vet fjalia në nenin 119 që thotë; që lejimi i monopolit mund të bëhet për interesa publike, në mënyrë eksplicite përjashton çdo argument që këta po e quajnë huti, në ligj.

Ligji askund në mënyrë eksplicite nuk e lejon monopolin. Përkundrazi, gjuha e secilit që është në fuqi e përjashton atë, përfshi edhe projektligjin për automjete.

Ta zëmë, vërtetë ky qenka problemi. Asnjë problem dhe asnjë hezitim sot, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e ka, që sot t'i qesim nënshkrimet në ndryshimet që ju po i kërkonin për ligjin.

Po e përsërisë, nuk është që lejohet një gjë e tillë, sepse e ndalon Kushtetuta.

Po, ta zëmë edhe sikur Kushtetuta jonë të ishte e paqartë, dikush më herët i përmendi standardet evropiane. Ky Kuvend i Republikës së Kosovës ka ratifikua me 2/3 Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim.

Ajo marrëveshje ka krijuar obligime kontraktuale, ndërkombëtare për Republikën e Kosovës. Ndër këto obligime kontraktuale në raport me Bashkim Evropian si palë e asaj kontrate, pra MSA-së, është eliminimi i monopoleve në të gjitha fushat, përfshirë edhe këtë për homologim.

E çka thotë tash Kushtetuta në rastet kur kemi një marrëveshje ndërkombëtare; ajo marrëveshje është mbi secilin ligj. E sqaroj edhe dje Gjykata Kushtetuese se cila është hierarkia jonë kushtetuese e të gjitha akteve juridike.

E kemi Kushtetutën. I kemi aktet ndërkombëtare ose marrëveshjet ndërkombëtare dhe ama bash hiç asnjë relevancë nuk kanë ato hutitë që qenkan krijuar në kokat tuaja, se çfarë shkruan ky ligj ose ai ligj. Asnjë fare.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në momentin që ka hyrë në fuqi dhe është ratifikuar në këtë Kuvend, ka ndryshuar automatikisht secilin ligj që mund të ketë qenë në kundërshtim me të.

Prandaj, ky udhëzim administrativ që po tentohet që të mbahet në fuqi sot, lerë që bie në kundërshtim me aktet juridike që ne i kemi miratuar, por edhe po tregon që ai orientimi strategjik për të cilin e kanë gojën plotë, secili që vjen këtu edhe flet, pra orientimi properëndimor, orientimi proevropian.

Nuk qenka bre aq serioz, sepse po të ishte, nuk do të lejonte Republika e Kosovës që të shkelet Marrëveshja për Stabilizim-Asociim.

Sikur të ishte, nuk do të lejonte Republika e Kosovës që ta konsiderojë Kushtetutën sikur një letër të pavlerë. Sikur të ishte me rëndësi, nuk do të lejonte Republika e Kosovës që të injorojë secilën letër, që qe një vit është duke e dërguar përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës, zonja Apostolova.

E tani, çka thotë ndër të tjera ajo në këto letra. E kemi parë edhe janë publikuar edhe nëpër media.

A ka më marre sesa përfaqësuesja e Bashkimit Evropian, ku ne po synojmë që një ditë të hyjmë të thotë; që në zyrat e ministrisë paska shkuar dikush nga përfaqësuesit e monopolit në këtë rast, të kompanisë që e ka monopolin, për të marrë pjesë në shkrimin e udhëzimit administrativ.

Dhe, jo rastësisht tash ky udhëzim administrativ tenton që ta vazhdojë këtë marrëveshje mirëkuptimi të cilin e përmenda qysh në fillim.

Pra, ky Kuvend, në qoftë se vërtetë e kemi seriozisht secila parti politike çka foli sot, e ka para vetes, jo vetëm një çështje të thjeshtë siç është homologimi. Ky Kuvend sot, vendos në qoftë se dëshiron që para interesave individuale ose të grupacioneve të caktuara, para interesave të tyre financiare, i vendos vlerat mbi të cilat ne e kemi ndërtuar këtë shtet.

Sigurisht se, këto vlera, përfshijnë edhe eliminimin e monopoleve. Ato vlera, përfshijnë edhe konkurrencën e lirë. Ato vlera, përfshijnë orientimin properëndimor dhe proevropian të popullit të Kosovës. Pra, ato vlera mbi të gjitha përfshijnë edhe mbrojtjen e interesi të qytetarëve të cilët me të drejtë u përmend nga disa deputetë që po maltretohen me procedurat që po vendosen nga ana e monopoleve.

Pra, puna është shumë e thjeshtë para nesh sot. A dëshironi që ky propozim i LDK-së të ndryshojë dhe të përfshijë që brenda afatit dyjavor të propozohet nisma legislative që të ndryshohet, nëse doni Ligjin për Automjete apo ligjet tjera, që të gjitha.

Në të gjitha, unë do ta vendos nënshkrimin. Po, mos harroni, as nuk ka qenë e as nuk është problemi te aktet teknike. Problemi ka qenë dhe mbetet tek vullneti politik, zonja e zotërinj. Tek vullneti politik që të ç'kapet prej financierëve të caktuar, të cilët për fat të keq, nuk e kontrollojnë vetëm fushën e homologimit, por po tentojnë ta kontrollojnë këtë shtet në tërësi. Kjo duhet të ndryshojë njëherë e përgjithmonë. Të ndryshojë njëherë e përgjithmonë, që alfa dhe omega e veprimeve tona politik e publike të jetë Kushtetuta në të cilën jemi betuar, dhe jo interesat më të vogla të cilat pastaj shkelin interesat e qytetarëve tanë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, Vjosa! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së nuk ka të paraqitur. Kalojmë te Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Do ta ndjek linjën e njëjtë siç e adresoi edhe zonja Osmani.

Së pari, janë tre persona që do duhej që të ishin sot në këtë seancë. Tre persona të Qeverisë, që është kryeministri Haradinaj, i cili tashmë sapo pashë që paska takuar deputetin Danush Ademi, në këtë kohë kur ne jemi duke diskutuar për një çështje shumë të rëndësishme.

Pra, ja ndërtesa e Qeverisë është shumë afër, duku dy-tre hapa, dhe mund të jetë këtu i pranishëm në vend se të bëjë takime që nuk janë urgjente as të jashtëzakonshme, me deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kinse për të treguar gatishmërinë e Qeverisë për komunitetin që përfaqëson zoti Danush Ademi.

Tash, kjo natyrisht që është e papranueshme dhe qasje e papërgjegjshme.

Përveç kryeministrit Haradinaj, në këtë seancë të jashtëzakonshme, shumë të rëndësishme do duhej të ishte edhe zëvendësi i tij, Fatmir Limaj, i cili e nisi këtë monopol të homologimit. Dhe, përveç Fatmir Limajt do duhej që të ishte edhe Pal Lekaj në këtë seancë. I cili po tenton që t'ia vazhdojë monopolin Devollëve.

Vet fakti që bash asnjëri prej tyre sot nuk janë në këtë seancë të jashtëzakonshme, madje as edhe një ministër i kësaj Qeverie tregon interesin e këtyre personave të kësaj Qeverie, për të vazhduar me monopol të Devollëve.

Fjalimin tim po nis me nenin 119, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe meqë e kam Kushtetutën këtu para vetës po e lexoj saktësisht se çfarë shkruan.

Paragrafi 3 i nenit 119 thotë: Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë nëpërmjet vendosjes ose abuzimit të pozitës dominues ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejon në mënyrë eksplicite me ligj.

Dhe, siç e përmendi edhe zonja Osmani, askund në asnjë ligj, nuk lejohen në mënyrë eksplicite. Pra, Kushtetuta e Republika së Kosovës ka hyrë në fuqi në vitin 2008. Pra, diku në mars të viti 2008, dhe lejimi i monopolit ka ndodhur në vitin 2008 po ashtu, në gusht të vitit 2008, në pushime verore.

Kjo, meqë këto vendime të tilla dhe favorizime të tilla, i bëjnë pikërisht në pushimet verore, kur duket që s'ka vëmendje shumë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Që 11 vite, prej kur këtë monopol të Devollit ia lejoi ish-ministri Fatmir Limaj dhe së bashku me Adem Grabovcin, sepse edhe Adem Graboci është munduar në këtë drejtim.

Pra, që 11 vjet, duke nisur nga Fatmir Limaj, tek secila qeveri pas vitit 2008, kanë qenë në shkelje kushtetuese. Dhe, a e dini se ku është problemi këtu, menjëherë pasi ka hyrë në fuqi

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, menjëherë kanë filluar shkeljen e saj dhe s'po e përfundojnë as sot.

Siç e keni parë edhe dje aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ku dëshmon shkelje të shumta kushtetuese.

Një do të dalë kjo Kushtetutë dhe do të thotë; o mos më shkelni më! S'la Qeveri, s'la president, s'la deputet pa e shkelur këtë Kushtetutë të Republikës së Kosovës në të cilën jeni thirrur shumë.

Neni 119, paragrafi 3 po thotë që, nuk lejohet kufizimi i konkurrencës dhe në anën tjetër shprehimisht e ndalon monopolin.

Tjetra, zoti Sherifi tha që ka pasur shpallje publike, domethënë në momentin kur është para hartimit të atij udhëzimi administrativ. Por, zoti Sherifi, është dashur që para se të vijë në këtë seancë, ta pyes kryetarin e partisë së tij, se si ka ndodhur ky proces.

Në atë kohë s'e ka pasur kryetar, ka mundur të mos jetë i informuar, edhe nëse do ta kishte nuk e di nëse do ta kishte informuar, por megjithatë është dashur, meqë po flitet për një çështje shumë të rëndësishme, ku përgjegjësinë kryesore e bartë Fatmir Limaj dhe jo vetëm, sepse i përmenda edhe personat tjerë, është dashur që të konsultohet.

Nuk ka pasur shpallje publike dhe këtë e konfirmon edhe një institut shumë i rëndësishëm, është instituti GAP, që unë po e përmend, s'e kam marr lejen, por ky është publik dhe prandaj po i referohet të njëjtit.

Ky institut, thotë që ministria nuk ka shpallur procedura të tenderimit, duke shmangur në këtë formë edhe konkurrencën, dhe duke i dhënë qasje ekskluzive vetëm një kompanie. Pra, këtë e thotë edhe instituti GAP, dhe unë ju ftoj që ta lexoni këtë analizë që është shumë e detajuar dhe shumë e vlefshme.

Pra, kjo është bërë, e para për ta favorizuar "Euro-Labin" apo Devollët dhe, e dyta për t'i zhvatur qytetarët. Pse po them për t'i zhvatur qytetarët, sërish po i referohem kësaj analize të Institut GAP. Për shembull, Franca që ka standardin shumë të lartë në krahasim me Republikën e Kosovë, e ka 80 euro homologimin, Kosova e ka 125 euro. A e dini çka do të thotë për qytetarët e Republikës së Kosovës, me pagat mesatare deri në 400 euro, e me paga minimale ose me të ardhura minimale 170 euro, ta kenë 125 euro homologimin. Ose a dini që Maqedonia e ka 90 euro, po flas tash për vendet e rajonit. Mali i Zi 30 deri në 80 euro, Kosova 125 euro. Kjo nuk është asgjë tjetër përveç zhatje dhe abuzim mbi qytetarët e Republikës së Kosovës.

Më tutje, ne konsiderojmë që nuk ka asnjë ligj, bash asnjë ligj në Republikën e Kosovës që e lejon monopolin, madje as ai për automjete, por edhe nëse do ta lejonte ndonjë ligj monopolin, unë e përmenda nenin 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe unë nuk po e di deputetët a e dinë epërsinë e Kushtetutës, pra që Kushtetuta ka epërsinë mbi ligje.

Dhe po i referohem nenit 16 që thotë epërsia e Kushtetutës, Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutë, këtë e mëson në shkollë fillore. Këtu nuk ka nevojë për ndonjë interpretim, është Kushtetuta që vlen mbi secilin ligji. Prandaj, secili ligj duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ministri Pal Lekaj e arsyeton Udhëzimin administrativ mbi bazën e Ligjit për automjete, konkretisht ai thirret në nenin 34.1 dhe sidomos në paragrafin 2.

Pra, ministri thotë se këtu nuk po shkruan “subjekte” por “subjekti”. Pra, ministri insiston, ndonëse unë jam e bindur që ai është në dijeni për interpretim të gabuar, ai insiston që këtë monopol t’ia lejojë dhe t’ia vazhdojë Devollit.

Pra, ky është interpretimi më banal dhe më absurd që kemi mundur ta dëgjojmë apo ta hasim, sepse nëse lexohet Ligji për automjete nga neni 1 e deri në fund të tij, e sidomos neni 16 më lejoni që t’i referohem specifikisht nenit 16 thotë: “Obligimet e subjekteve të autorizuara për homologim”, pra në shumës. Subjektet e autorizuara për homologim duhet të sigurojnë që prodhuesit të cilët aplikojnë për homologim t’i përmbushin kërkesat teknike dhe procedurën e paraparë me dispozitat e këtij ligji. Pra, as ky ligj nuk lejon monopol, është fjala për shumës, “subjekte”, jo “subjekt”, por kështu po i përshtatet Pal Lekajt dhe kësaj Qeverie, prandaj këta insistojnë në këtë.

Dhe po ashtu bazë duhet të jetë edhe Ligji për marrëdhëniet e konkurrencës, i cili është ligj antimonopol dhe po ashtu Kosova ka Agjenci të Konkurrencës që e ndalon monopolin.

Përveç pikave të propozuara nga subjekti politik LDK, ne besojmë që janë të rëndësishme edhe dy të tjera.

E para, duhet të jetë edhe një pikë me këtë formulim:

“Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit njofton subjektin e autorizuar për përfundimin e autorizimit për periudhën e dhënë, për periudhën tranzitore deri në plotësimin e pikës 3, këto kompetenca i ushtron ministria sipas kompetencave të dhëna në Ligjin për automjetet”.

Dhe një çështje tjetër që u përmend disa herë këtu. Ligji për automjete, meqë po thuhet që ai duhet të ndryshohet që ne nuk besojmë që ka ndonjë problem dhe argumentimin e bëra për këtë.

Ne e kemi gati si Lëvizje Vetëvendosje projektligjin e hartuar, i cili i ka 4 nene dhe t'ia bëjmë sikurse e bëmë me procedurë të përshpejtuar për lojërat e fatit, me...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Një minutë shtesë, ju lutem!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zakonisht e përcjell, por thashë më iku.

Domethënë është projektligji gati, e marrim deklaratën financiare në mënyrë të përshpejtuar, edhe atë 'acquis communautaire' dhe qeveria menjëherë mblidhet e jep mendimin dhe Kuvendi vazhdon në procedura të përshpejtuar.

Kjo është diçka që duhet ta bëjmë menjëherë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Albulena! Për nismën legjislative, siç e dini, ju duhet t'i drejtoheni Kryesisë së Kuvendit, pastaj Kryesia ia përcjell Qeverisë.

Shefi i Grupit Parlamentar të Nismës ka kërkuar replikë. Po, Teuta, pastaj, pas Bilallit. Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Veç desha të sqaroj që, po jam i informuar mirë se çka ka ndodhur dhe është mirë që kur t'u referohemi fjalëve të njëri-tjetrit, të jemi të saktë. Unë nuk thashë që ka pas tender dhe thashë ka pasur shpallje të interesit. Sepse sipas Ligjit për prokurim publik të vitit 2008, shpallje e tenderit ka qenë e detyrueshme kur kanë qenë të implikuara fondet publike, pra paraja publike dhe jo edhe dhënia me koncesion apo shërbime të caktuara të tilla.

Pra, në kohën kur është kontraktuar kjo nuk ka qenë e detyrueshme shpallja e tenderit, nuk thashë tender, jam i saktë në atë që them, përkundër asaj që kolegia ma përdrodi fjalën. Pra, e përmendi fjalën shpallet interesit, ndërsa pastaj tha nuk ka pasur tender. Unë e di që nuk ka pasur tender, sepse nuk ka qenë e detyruar, a ka qenë mirë a ka qenë keq ligji në atë kohë, është çështje tjetër, sa i përket kësaj çështje.

Dhe, nëse do të mund t'i kthehem për pak tash çështjes në fjalë. Po, çmimi ka qenë i lartë, çmimi duhet të ulet, gjithsesi që tani e tutje duhet të ulen përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe të gjejnë një modalitet që këtë ta ndërprejnë në mënyrë që qytetarëve t'u hiqet kjo barrë, por homologimi si proces është vendim politik, të cilin besoj me marrëveshjen edhe të MSA-së duhet



sqaruar a mund ta heqim apo s'mund ta heqim, por gjithsesi që lehtësime për qytetarët duhet të krijohet. Këtë sqarim desha ta bëj sa i përket asaj që u apostrofova. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, dy minuta replikë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Meqë e kishim një takim të Grupit të Grave Deputete u largova, por prita në fillim reagimin e zotit Zharku, shkoi e u konsultua me dikë, por megjithatë edhe sa e dëgjova nuk tha asgjë.

Po e ripërsëris edhe një herë, ju zoti Zharku keni bashkëjetuar paqësisht në mandatin tuaj si ministër me monopolin e homologimit, keni bashkëjetuar paqësisht. Pse nuk keni marrë pjesë në Komisionin profesional, për çka jeni i obliguar për të dhënë kontributin si deputet dhe për të thënë argumentet e zgjidhjes apo ndërprerjes të një rruge të gabuar, me të cilin ju keni bashkëjetuar gjatë mandatit tuaj.

Pra, në këtë pyetje nuk më dhatë përgjigje. Është mirë që po reflektohet në atë që e thamë që në fillim. Nëse duam zgjidhjen e këtij problemi, ejani ta ndryshojmë ligjin. Pra, ne jemi gati për ta ndryshuar ligjin dhe për ta ndaluar monopolin, por pa u kthye në retroaktivë për të treguar edhe një herë, por dikujt vërtet iu ka dukur shumë e mirë një bashkëjetesë, por ndonjëherë mandatin nuk e ke për të qëndruar qetësisht apo në komoditet në cilëndo ulëse, por duhet të jesh i përgjegjshëm për detyrat që i keni marrë.

Andaj, edhe një herë, pyetja është: Pse nuk keni marrë pjesë në komisionin për t'u ballafaquar me ministrin aktual, ti si ish-ministër si më i thirrur, si më profesionisti konsideroj nga të gjithë anëtarët që janë në komision, por jeni larguar sot, edhe pse e deklaruat që ministri nuk është këtu, po nuk është mirë, por megjithatë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku, kundër-replikë.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Prapë për kolegen Haxhiu, besoj se prezenca ime sot këtë për të më dëgjuar gjithë Kosova mjafton për ta kuptuar çdo qytetar se çka mendon LDK-ja dhe çka mendoj unë për këtë çështje.

Përndryshe, edhe unë kam mundur të shkoj diku jashtë ta shpik një konferencë edhe të shkoja në Crans Montana e të mos qëndroja këtu për t'iu përgjigjur deputetëve për çështje të tilla.

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dëgjuam shumë deputetë, kolegë, dëgjuam akuza dhe kundëraakuza dhe po më vjen mirë, jo në fakt s'po më vjen mirë që një parti politike siç e ka zakon gjithmonë përdor etiketime të ulëta, qoftë për deputetë, po qoftë edhe ministra, e më së pakti që sot ministri nuk është këtu. Edhe ne kemi etiketime për subjektin që po i përdorë këto etiketime dhe mundem ndoshta t'i quaj edhe Stalinistë, edhe Leninistë edhe me plot etiketime të tjera dhe t'i pyes se cilin libër e kanë lexuar këtë javë që e kanë obligim ligjor ....

KRYESUESI: Ju, zonja deputete, jo mundeni, ju po e bëni.

TIME KADRIJAJ: Po, po i bëj se ju po i lejoni ato...

KRYESUESI: Së paku konstatohet që po e bëni.

TIME KADRIJAJ: Po! Nëse po i hyjmë një problemi prej fillimi, po mundohemi t'i kalojmë situatat e caktuara. Nëse është një problem dhe po duan ta elaborojmë një problem, të mos bëjmë shkëputje në periudha të ndryshme kohore, po të fillojmë ta elaborojmë problemin prej ditës që është formuar ose prej ditës së parë që kemi filluar me homologim e deri sot. Jo tash po e bëjmë një shkëputje, një subjekt po e bën një shkëputje, po fillon me PDK-në, po del pak te Nisma, po e bënë një kapërcim, tash LDK-në po donë ta amnistojnë, sepse jeni partnerë të opozitës, edhe tash po doni të bëheni mirë, pavarësisht prej të gjitha atyre ngjarjeve që kanë ndodhur para këtij mandati, edhe pse janë shkuar e kanë gjuajtur shtëpinë e kryetarit tuaj, po bëjnë një kapërcim e tash po dalin te Pal Lekaj. Edhe tash jo, nëse ndërtohet një shtëpi, shtëpia ndërtohet prej themelit dhe nuk fillohet prej kulmit, se nuk rri. Ato themele e mure i kanë ndërtuar edhe PDK-ja, edhe LDK-ja, e tash te kulmi po dilni te Pali, kjo nuk është në rregull, se të gjithë janë fajtorë, asnjë nuk është i pafaj këtu. Më së pakti është fajtor Pali që e ka gjetur dhe e ka trashëguar një situatë të tillë.

Ligji është miratua në vitin 2017, dhe pak javë para se të shkonte Qeveria Mustafa. Dhe po thirrem në nenin 34, "Kushtet funksionale dhe operative". Ku saktë në paragrafin 1 shkruhet: "Subjektet e autorizuar për homologim duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim: Kushtet hapësinore dhe materialo teknike që sigurojnë ofrim në territorin e Republikës së Kosovës, kuadër përkatës profesional, organizim të punës dhe strukturë organizative që garanton realizim të punëve afatgjata dhe kualitative, përkrahje përkatëse në aspektin teknik dhe të informatikës për kryerjen e punëve, kushtet e tjera specifike që përcaktohen me një akt nënligjor".

Dhe, paragrafi i dytë që është shumë i rëndësishëm, është "subjekti i cili plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet licenca me afat të pakufizuar, me kusht që në mënyrë të pandërprerë i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji".

Dhe, ashtu siç e thanë kolegët paraprakë, Kushtetuta është mbi ligjin, edhe ligji është mbi Udhëzimin administrativ dhe tash gjithë këto janë bërë me anë të ligjit. Gjithë parafolësit e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e thamë qartë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është kundër monopolit të homologimit, është kundër çmimeve të larta.

Të nderuar deputetë,

Në vend që të ishte thirrur kjo seancë, meqenëse është një situatë urgjente, edhe unë po propozoj ndryshimin e ligjit.

Ligji është votuar 2-3 javë pak kohë para se të binte Qeveria Mustafa dhe është votuar nga legjislacioni i kaluar. Kushtetuta është mbi ligjet dhe ligjet janë mbi urdhëresat administrative dhe ne sot po sillemi te urdhëresat administrative, atëherë edhe parafolësit po bien ndesh: a është ligji më i madh se sa urdhëresa administrative, atëherë ose atë çka po e elaboroni po thoni që urdhëresa administrative është mbi Kushtetutën dhe është mbi ligjet e Kosovës, që s'është e vërtetë. Hajde ta nisim një nismë legjislative, pra ta ndryshojmë, edhe Aleanca është për, ta nisim ose ta marrë përsipër komisioni përkatës, ose t'i marrim nënshkrimet disa deputetë dhe të fillojmë ta hartojmë një ligj që eliminon monopolin. Aleanca është për dhe do ta përkrahë, por atëherë unë i kisha lutur kolegët deputetë, ta votojnë, sepse ka pasur shumë ligje të rëndësishme, të cilët s'i kanë votuar, qysh t'u besohet këtyre deputetëve ku edhe Ligjin e pagave s'e kanë votuar, që është ligji më i madh edhe më i mirë që ka ndodhur në historinë e pasluftës.

Por, prapë po them, në emër të Aleancës, Aleanca është kundër monopolit, Aleanca është kundër çmimeve të larta dhe Aleanca ju fton të formohet një grup dhe të fillohet një nismë legjislative për ta ndryshuar ligjin, sepse mos elaboroni një urdhëresë administrative, ku ligji po e thotë saktë. Lexojeni dhe interpretojeni ashtu siç shkruhet, sepse ligji nuk interpretohet dhe nuk thuhet sipas tekeve individuale të disave, jemi kundër monopolit, fillojeni me një nismë legjislative, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Glauk Konjufca, replikë, dy minuta!

**GLAUK KONJUFCA:** Desha të lidhem në këtë interpretim që e bëri kolegja Kadrijaj, sepse kjo e ka marrë tërësisht interpretimin që e pati ministri Lekaj atë ditë kur e patëm në Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe për të cilin nuk u pajtuam fare, sepse për të bërë një krahasim semantik, nëse doni, kjo është sikur të thuhet kështu: deklarata universale e të drejtave të njeriut i mbron vetëm të drejtat e një njeriu, sepse e ka emrin deklarata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, a po shkruan njëjës "të njeriut"? Pra, pasi po shkruan njëjës të njeriut, kjo i mbron të drejtat vetëm të një njeriu, kështu Pali e interpretonte ligjin.

Domethënë, kjo është një huqje jo vetëm kështu pikëlluese, por me të cilin edhe nuk bën të merremi gjatë e të humbim kohë, se kjo është aq e qartë, e leximi i ligjit është aq i gabuar, të cilin

e bëri edhe Time Kadrijaj sa i përket subjektit, edhe sa i përket asaj kohës të pakufizuar, sa që kjo meriton përnjëmend një kritikë të ashpër nëse ligjet lexohen kështu. Po thotë aty “subjekti”, po natyrisht aty së pari e kemi Kushtetutën, e cila nuk i lejon monopolet, tash kushdo që konkurren, secili subjekt kur ti thua “secili subjekt”, nuk e ke që veç “Euro Labi” duhet pasur atë të drejtë, edhe kur thua ti “mund të kenë licencë të pakufizuar”, nuk e nënkupton që nuk duhet të tjerët të konkurrojnë, nëse paskan licencë të pakufizuar. Edhe tjetra, kur i përfundon kontrata ai duhet me e...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj, kundër-replikë!

**TIME KADRIJAJ:** Për besë nuk po më çuditin këto deklaramet e Glaukut dhe tash bile-bile pas këtij deklarami unë po dyshoj a janë për ta bërë ligjin a s’janë, se dikush është i interesuar të mbërrijë diçka, nuk e akuzon atë që ofron përkrahje. Jo, që ofron përkrahje, jo e kemi mësuar, Glauk, nuk jeni veç ju, e kemi mësuar edhe ne dimë të lexojmë e të shkruajmë, sepse kështu këtë qëndrim e kanë pasur Vetëvendosja, se na kanë akuzuar edhe për kazinot, jo Ramushi, jo Ramushi, por Ramushi e pati guximin e i mbylli edhe kazinot, por nuk e di a janë vërtet të interesuar ta ndryshojnë ligjin dhe ta ndalin këtë monopol në homologim, sepse përndryshe e kishin mirëpritur një deklaratë të një partie që është në qeveri që po ofron përkrahje.

Tash mua po më bëjnë të dyshoj që këta nuk janë të interesuar ta ndryshojnë, po të vazhdojë kështu, po veç fjalë e llafe, se na kanë lodhur si dje, si sot, po pa asnjë rezultat konkret.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Vjosa Osmani-Sadriu, replikë dy minuta, sepse është përmendur edhe Lidhja Demokratike e Kosovës.

**VJOSA OSMANI-SADRIU:** Unë besoj që isha e qartë më herët që LDK-ja nuk ka asnjë hezitim që si pjesë të këtij vendimi të Kuvendit sot të kërkojë që të ndryshohet Ligji për automjete, meqenëse po kërkojnë qartësim mbi diçka që tashmë është e qartë në atë ligj dhe që po ashtu është e qartësuar edhe me akte më të larta juridike.

Mirëpo, po e përmend edhe një fakt tjetër, pse vazhdimi i asaj të ashtuquajtur kontratë që, në fakt ka qenë marrëveshje mirëkuptimi, nëpërmjet Udhëzimit administrativ është i kundërligjshëm. Kur është nënshkruar ajo marrëveshje mirëkuptimi në vitin 2008, në paragrafin e fundit ka paraparë që plotësimi i saj, që nënkupton edhe vazhdimin e saj, mund të bëhet vetëm me nënshkrimin e dy palëve që atëherë kanë qenë palë e kontratës, është parim bazik juridik që në të njëjtën mënyrë që nënshkruhet një kontratë, në të njëjtën mënyrë edhe duhet të vazhdohet ose të ndryshohet.

Pra, nuk mundet të vazhdojë homologimi pa një kontratë të re, nuk mundet një udhëzim administrativ si akt nënligjor të vazhdojë kontrata mes Qeverisë dhe palëve private, nuk e lejon asnjë parim bazik në drejtësi, pra kjo e bën tërë atë akt nënligjor që është Udhëzim administrativ të pazbatueshëm. Tregojeni atë guxim që po e përmendni sot tërë ditën, mos e zbatoni në praktikë se e thashë edhe më herët, s'është kjo punë teknike qysh interpreton ti ose unë ligjin, është punë e një vullneti për të mos e zbatuar në praktikë ligjin, le të kërkojmë në rezolutë që nëpërmjet kthimit në lexim të tretë të Projektligjit në automjete që tash është në procedurë, e ndryshojmë e ua qartësojmë përfundimisht një gjë që tashmë është shumë e qartë në nenet 33 deri 35.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Time Kadrijaj, kundër-replikë, një minutë!

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, nënkryetar! Unë bile në fjalët e Vjosës nuk aludova hiç, unë shumë mirë e përkrah iniciativën e asaj edhe atë interpretimin e saj që tha se Kushtetuta është mbi ligjin, por njëkohësisht e vazhdova që ligji është mbi urdhëresën administrative. Edhe, një herë e thashë, të bëhet interpretim i qartë dhe të fillohet të mos barten problemet te ministri i tashëm, problemet kanë filluar prej fillimit edhe të gjitha këto palë që jeni e keni pasur ministrinë e caktuar dhe e keni sjellë këtë situatë të homologimit dhe të monopolit, ka ardhur deri këtu. Tash ministri Pal Lekaj e ka gjetur situatën qysh e ka gjetur edhe kontratën qysh është, s'ka bërë kurrëgjë, prapë si Aleancë, po ofrohemi në nismën legjislative për plotësim-ndryshim të Ligjit për automjete, jemi kundër monopolit, kundër çmimeve të larta, pranoni gatishmërinë tanë, veç nëse s'jeni dakord...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ia jap fjalën sipas radhës deputetit Enver Hoti.

**ENVER HOTI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Seanca është e rëndësishme për vetë faktin, jo vetëm për temën dhe situatën që ka krijuar kjo gjendje si temë e ditës, ose temë e rendit të ditës që është homologimi, por për vetë faktin që po diskutohet dhe po debatohet për mundësinë e ndalimit të monopoleve dhe unë nuk dua të shtoj asgjë më shumë, sepse qëndrimi ynë dhe i partisë tonë është që të zhvillohen situata dhe jemi në mbështetje të plotë të gjitha masave dhe veprimeve që t'i marrim edhe si Kuvend, edhe si institucione për ndalimin dhe ndërprerjen e monopoleve kudo që janë ato.

Mirëpo, si zakonisht në debatet e tilla, të cilat janë shumë të rëndësishme për funksionimin e institucioneve dhe për interesin e qytetarëve të vendit, e gjithmonë të zhvendosen dhe barten në binarët e tjerë, të cilët shpeshherë disa kolegë deputetë marrin rolin e hetuesit, prokurorit, gjykatësit apo të ndonjë profesionisti tjetër, siç ishte rasti sot i Glauk Konjufcës. Unë me vëmendje e dëgjova fjalën e Glaukut dhe për besë më befasoi se u fut në atë mashtrimin e

propagandës, gjë që dje e vërtetua qartë, e pamë se ai e ka një natyrë ashtu edhe një aktivitet bukur të qëndrueshëm për të propaganduar, por në anën tjetër nuk po mundte ta bartte propagandën, sepse e vërtetua me atë Ligjin që ishte për sportin, bukur e kishte pas rënduar situata kur ai e kishte perceptuar që dikush paska bërë propagandë kundër Vetëvendosjes. Unë do të shkoj me një temë tjetër jashtë kësaj situatë. Kur e pati marrë pushtetin Vetëvendosja në Prishtinë në vitin 2013-2014, pati marrë një vendim për ndalimin e lejeve të ndërtimit. Cila ishte arsyeja? Për të vendosur rend dhe rregull në industrinë e ndërtimit. Çka ka bërë zoti Glauk Konjufca, siç mund të jetë nën qëllime gjithmonë, është mirë të na tregojë cilën rrugë e ka ndjekur dhe çka ka ndodhur në Rrugën B me planifikimin urbanistik të qytetit, në atë kohë. Dhe, si ka rrjedhur zhvillimi i atij plani urbanistik?

Jo, jo, të lutem, ti s'ke nevojë të bërtasësh atje, prit, "ngadalë beg se ka hendek", apo e keni pas gjetur atë rrugën e mirëkuptimit me kompani të ndryshme për të bashkëpunuar e interferuar për interesa grupore e klanore e financiare, të cilat sigurisht i keni dhe i dini. Nëse jo, atëherë duhet dhënë përgjegjësi atyre njerëzve çka keni ndryshuar dhe çfarë rregulli keni vendosur në atë fushë, të cilën e keni pas penguar bukur gjatë derisa i gjet disa kanale që ju i dini vetë dhe sigurisht besoj që i dini mirë dhe mirë është t'u jepni përgjigje edhe qytetarëve të Prishtinës, por edhe neve këtu. Po, shpeshherë po dëgjojmë këtu që Vetëvendosja ka parime dhe nuk bashkëpunon me secilin, po na u përgjëruat more në vitin 2017 për të qenë bashkë në koalicion dhe në një listë të përbashkët, pikërisht me Nismën. Ju i dini lutjet që na i keni bërë dhe zvarritjet që i keni bërë karshi subjektit tonë për të qenë bashkë në një listë, ndërsa Isa Mustafës së shkretit ia keni pas sjellë shpirtin të dalë edhe prej shtëpisë së tij. Ndërsa, sot i shkoni në zyrë dhe krijoni raporte...

KRYESUESI: Zoti deputet, më duhet t'ju kërkoj të ktheheni në temën e seancës, se këto janë çështje të një natyre tjetër.

ENVER HOTI: Unë jam brenda temës time...

KRYESUESI: Jo, jo, s'jeni aspak.

ENVER HOTI: Jo, jo, absolutisht jam brenda temës time dhe...

KRYESUESI: Jo, jo, në seanca plenare të zakonshme kemi deklarime jashtë rendit të ditës, aty mund t'i bëni.

ENVER HOTI: Unë mendoj dhe jam i bindur për këtë, sepse e kam parë edhe gjatë një bashkëpunimi që e keni pasur ju si opozitë e bashkuar që nuk ka fare parime nga ato që i ngritin këta kolegët e mi deputetë të Vetëvendosjes, por vetëm bëjnë tentativa për të ardhur në pushtet pa zgjedhur asnjë mënyrë, vetëm të zgjedhin kush...

KRYESUESI: Në rregull, por është çështje tjetër, s'po bisedojmë për Lëvizjen Vetëvendosje.

ENVER HOTI: Është legale dhe është legjitime, edhe një po dua ta them, u tha këtu që komisioni, ekipi shtetëror ka dalë antiligjor, unë nuk dua ta komentoj vendimin e gjykatës, por dua të deklaroj këtu para qytetarëve, aktiviteti i LDK-së dhe i Vetëvendosjes dhe vendimi i gjykatës e kanë forcuar Hashim Thaçin dhe këta ia pafshin hajrin dhe... e kanë marrë një rol të mirë, ia kanë bërë një argat shumë të mirë, tani le të ballafaqohen me zotin Thaçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, patjetër të gjithë, po kjo fjala e kolegut tonë të nderuar ishte plotësisht jashtë objektit të cilin po e trajtojmë. Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje kush do replikë? Glauk Konjufca, dy minuta.

GLAUK KONJUFCA: Kisha përtuar fort t'i replikoj këtij diskutimi kaq të dobët, po më ka rënë hise si shef i grupit tash, mirëpo siç thatë ju, edhe nuk ishte fare në temë, i bëri disa akuza të pabaza, duke bërë një ekskursion kështu fantastiko-shkencor, duke filluar prej ndaljes së lejeve të ndërtimit të Vetëvendosjes në Prishtinë, gjë që nuk ka ndodhur kurrë. Ndalja e lejeve ka mundur të ndodhë vetëm për ato ndërtimet pa leje janë ndalur në Prishtinë, kurse sa u përket lejeve që janë dhënë, është e vërtetë që janë reduktuar dukshëm, por janë reduktuar sepse janë pranuar vetëm ato që janë sipas kushteve ligjore.

Pra, prej 60 apo 70 lejeve për ndërtime të mëdha, kanë rënë në 20-30, janë përgjysmuar gjatë kohës së Vetëvendosjes, kjo ka ndodhur për shkak se ka pasur me siguri pak më të ashpra dhe për t'u plotësuar kriteret ligjore. Sa i përket këtij vendimit të Kushtetuesës, ky është një interpretim i çuditshëm që është duke e bërë Nisma, sepse ai e ka goditur edhe Presidentin, ai interpretim i Kushtetuesës. Po më duket, zoti Hoti, nuk e ka lexuar krejt vendimin, sepse kishte qenë pak i gjatë, ndoshta nuk ka pas kohë, mirëpo vendimi thotë: "Presidenti ka marrë në mënyrë jokushtetuese kompetencat në fushën e politikës së jashtme. Kjo është shumë shqetësuese, sepse presidenti ynë ka shkuar atje pa bazë kushtetuese dhe i ka propozuar Vuçiqit zgjidhje për Kosovën, që prek edhe kufijtë e Kosovës.

Pra, pse ju tash nuk po e merrni atë vendim si kritikë edhe për ju edhe për presidentin, por po e interpretoni në mënyrë selektive, thuajse ajo e amnistion Presidentin. E unë mendoj që, edhe pres...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enver Hoti kundër-replikë, një minutë!

ENVER HOTI: Sa për korrektësi, se mirë shumë, dikush di t'i bishtnojë ikjes nga përgjigja. Kryetari i Shoqatës së Arkitektëve, zoti Eleisi Surdulli, më 30 mars 2017 tregon qartë se nuk

është zbatuar plani i urbanizmit i miratuar në Komunën e Prishtinës në vitin 2010 dhe çka ka ndodhur dhe e ka ngritur temën “Çka është duke ndodhur në rrugën B”. Mirë shumë që Glauku e ka aftësinë me u ikë pyetjeve direkte, por e din mirë se çka ka ndodhur edhe shefi i grupit të Vetëvendosjes.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Vjosa Osmani-Sadriu, replikë 2 minuta, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

**VJOSA OSMANI-SADRIU:** Edhe pse tema e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk është temë e kësaj seance, më duhet të përgjigjem shumë shkurt. I rekomandoj deputetit ta lexojë arsyetimin e Gjykatës, në veçanti nga pika 85 e teposhtë. Emëruesi i përbashkët i këtij arsyetimi është një fjali “Roli i presidentit të vendit në aspektin e negociatave me Serbinë reduktohet në rolin e këshilltarit të kryeministrit.”. Kaq. Në rolin e këshilltarit të kryeministrit... Gjithçka tjetër është tepër e qartë. Është Qeveria, në këtë rast kryeministri, që udhëheq negociatat dhe ai nuk duhet t’i ikë e t’i bishtnojë më një përgjegjësie të tillë.

Do të ishte mirë që çdokush që e ka ndihmuar presidentin gjatë këtyre gjashtë muajve të fuqizohet dhe ta bëjë, nga një president që i ka pasur veç 20 veta prapa në një president me 61 prapa, tani ta kuptojë që ky ka qenë një gabim tepër i madh dhe të rreshtohen bashkë me ne, që jo vetëm ta rrëzojmë Qeverinë, por në të njëjtën kohë të sigurohemi që kushdo që e përfaqëson tash e tutje Republikën e Kosovës në Bruksel të mos ikë nga kjo përgjegjësi, sepse nuk ka përgjegjësi më të madhe se sa mbrojtja e interesit të qytetarëve në raport me Serbinë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Bilall Sherifi, si shef i grupit parlamentar, dy minuta!

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Unë e mbështeta idenë tënde që të tërhiqet vërejtja kur të dilet jashtë rendit të ditës, por u desh edhe koleges suaj nga partia juaj t’i tërhiqet vërejtja, se është jashtë rendit të ditës. Pra, le të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme edhe për këtë, sepse edhe ashtu i kemi me shumicë, me bollëk, dhe të debatojmë edhe për këtë.

Ndërsa, ju sa i përket kësaj çështjeje ne të gjithë e kemi ditur që kryeministri ka kompetenca të zhvillojë negociatat në bashkëpunim me presidentin për çështje të zakonshme, por kjo çështja e dialogut të gjithë e kemi ditur dhe e dimë se tejkalon kapacitetet institucionale dhe ideja ka qenë që Kuvendi të prodhojë, të nxjerrë, të votojë, një platformë me një delegacion ku do të përfshiheshin Qeveria, Presidenca, opozita për të zhvilluar negociata. Dhe, siç unë e gjykoj Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ajo krejt çka ka bërë ka thënë se dialogu në këtë mënyrë nuk mund të vazhdojë, sepse delegacioni është veshur me kompetenca ligjore, të cilat nuk ia jep Kushtetuta. Jemi në rregull, vazhdojmë më tej, ama të jeni të sigurt se duke i njohur aktorët kjo



fitorja e juaj do të jetë “Fitore e Pirros”, pra një humbje në fitore për ju kolegë të nderuar, që po i gëzoheni shumë kësaj fitoreje.

Uroj që të jetë fitore, por kam frikë se do të jetë “Fitore e Pirros” për ju! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Bilall! Vërtet është jashtë rendit të ditës, po e hapët ju. Domethënë, ajo e Vjosës ishte një replikë, reagim. Mund të vazhdojmë sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Fitore Pacolli-Dalipi. S’është këtu. Atëherë, Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo seancë e jashtëzakonshme për nga karakteri i saj është i një rëndësie tepër të veçantë për qytetarët tanë, sepse me vete faktin që trajton temën që ka të bëjë me homologimin e veturave tregon më së miri se pushtetarët e qeverive paraprake e po ashtu, edhe të kësaj të tanishmes, janë të zhytur thellë në afera të shumta korruptive përmes bashkëveprimit të ndërsjellë me kompani të caktuara biznesi, duke lidhur kontrata të dëmshme me të vetmin qëllim përfitimin e mundshëm material për vete apo për dikë tjetër, në mënyrë të kundërligjshme.

Kontrata e fundvitit 2008, që ka të bëjë me ofrimin e shërbimit të homologimit për veturat që hyjnë për herë të parë në Kosovë nga vendet e BE-së apo të rajonit, e nënshkruar nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe kompanisë “Euro-Lab”, e cila është në pronësi të vëllezërve Devolli, persona mjaft të afërt me pushtetarë të qeverive të kaluara, por edhe të kësaj qeverie, vë në pah shkelje të rënda të parimeve kushtetuese në rend të parë e pastaj edhe një varg shkeljesh tjera të dispozitave ligjore, të cilat janë në fuqi.

Përgjegjës për nënshkrimin e kësaj kontrate, e cila u nënshkrua direkt nga palët në fjalë, pa kërkuar në proces tenderimin përmes së cilës u bëhej thirrje publike për licencë, ish-in ministri i atëhershëm Limaj dhe zëvendësi i tij Adem Grabovci, person i cili përveçse është i njohur për marrëdhënie të afërta me vëllezërit Devolli, pa një ko incidencë e radhës.

Veprime të tilla të procedimit bien ndesh edhe me Ligjin për prokurimin publik, pastaj çka i bën edhe më të rënda shkeljet dhe krijon monopol në ofrimin e këtij shërbimi është autorizimi që i bën ministri kësaj kompanie, që të jetë ekskluzivisht e vetme në ofrimin e këtij kontrolli për një periudhë dhjetëvjeçare, duke eliminuar drejtpërsëdrejti konkurrencën e lirë që e garanton edhe neni 119, siç e thanë edhe parafolësit e mi, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas së cilës veprimet e të cilit kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes apo abuzimit të pozitës dominuese, ose të praktikave që e kufizojnë konkurrencën janë të ndaluara, me përjashtim kur lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.

Pra, të njëjtën kohë kjo mënyrë e lidhjes së kontratës ishte në kundërshtim edhe me ligjin që ishte në fuqi për konkurrencën, e cila përmes nenit 3 e ndalonte marrëveshjet monopolizuese si dhe Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, sepse në njërin apo tjetrin mënyrë i udhëzonte qytetarët që shërbimin mbi homologimin ta marrin tek kompania në fjalë. Ajo çfarë e shqetëson secilin qytetar të vendit është pozita dominuese monopoliste që ka kjo kompani e cila ka krijuar një ambient që qytetarët të cilët kanë nevojë të marrin një shërbim të tillë të mos kenë mundësi të zgjedhin vet kompaninë dhe çmimin më të volitshëm, por detyrimisht janë detyruar që këtë shërbim ta kryejnë tek kompania “Euro-Lab”, e cila për një kontroll homologimi merr mbi 125 euro, çmim që jo vetëm se është më i lartë se në vendet e rajonit por edhe në shumë vende të Bashkimit Evropian dominon si më i shtrenjti.

Përpyekjet modeste të pushteteve të kaluara, për të evituar pengesat që i kufizonte konkurrencën e lirë përmes vendimit të vitit 2015, me të cilin obligoheshin ministrinë të evitojnë dhe rishikojnë të gjitha barrierat që kufizojnë konkurrencën e lirë nuk patën efekt tek rishikimi i kontratës me “Euro-Labin”, sepse arsyetimin që e dha kjo kompani sa i përket monopolit që ka krijuar mbi ofrimin e shërbimit të homologimit, ishte se praktika monopoliste e shteteve të rajonit, si edhe ato të BE-së.

Studimi që ka ofruar instituti GAP tregon se është krejt e kundërta praktikë në shtetet tjera. Për shembull, në Maqedoni janë 5 qendra të licencuara për homologimin, si dhe çmimet të cilat ofrojnë ato sillen nga 30 - 70 euro, varësisht prej llojit të makinës, e njëjta praktikë funksionon edhe në Mal të Zi dhe në vendet tjera, përveçse në Kosovë. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Transportit nr. 2008/8, përveçse ka krijuar monopol në homologim, ka krijuar monopol tjetër edhe në rastin e përcaktimit të qendrës së autorizuar për homologim, mbikëqyrëse të qendrave tjera të kontrollit teknik, e cila në numër janë mbi 100 sosh çka vë në konflikt interesin direkt në këtë kompani.

Në rastin në fjalë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke marrë për bazë vendimin mbi arkat fiskale mund të ndihmojnë në shkëputjen e kontratës, që ka bërë me monopolin e kontrollit mbi homologimin, sepse shumë lehtë mund të argumentohet kjo marrëveshje është në kundërshtim me ligjet dhe kushtetutën dhe në dëm të interesit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve. Në Kosovë që nga nënshkrimi i kësaj kontrate janë importuar mbi 200 mijë automjete, ku secila prej tyre ka kaluar nëpër procedurën e homologimit tek ky monopol lokal, ku në shumë raste ka edhe pa kurrfarë nevoja sepse një numër i madh i automjeteve kanë qenë të reja, që paraprakisht veçse e kanë pasur certifikatën e homologimit nga vendet që janë prodhuar, duke ia mundësuar kompanisë “Euro-Lab” inkasimi me dhjetëra milionë euro.

Raportet e medieve janë mbi 70% marzhë fitimi apo mbi 6 milionë euro në vit dhe asnjëherë nuk kanë pranuar të jenë transparentë për këtë marrëveshje, “Euro-Labi” jo se jo, por as edhe ministria. Pra, me gjithë këto shkelje që përmban në vete kjo kontratë, u hap rrugën organeve të

drejtësisë për një hetim të mirëfilltë të saj, si dhe shprehje të menjëhershme të marrëveshjes dhe shfuqizimit të Udhëzimit Administrativ i cili krijon monopol në këtë fushë.

Prandaj, si shtet demokratik dhe me orientim euro-atlantik që pretendojmë të jemi, është më se e nevojshme që e ardhmja dhe veprimet që mund të ndërmerren për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, praktika të tilla monopoliste në dëmtim të interesit të qytetarëve të mos na përsëriten, kurse zyrtarët e lartë qeveritarë të cilët në bashkëpunim me bizneset e llojit të devollëve, të cilët kanë nënshkruar marrëveshje të tilla me të vetmin synim përfitimin pasuror në mënyrë të kundërligjshëm të vihen para përgjegjësisë penale. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Punën do ta vazhdojmë në orën 15:00.

\* \* \*

KRYESUESI: Albulena Balaj, regjia, ju lutem!

ALBULENA BALAJ-HALIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Udhëzimi Administrativ në vitin 2018 për homologim duhet të mos e quajmë udhëzimi monopoli. Ai udhëzim i është nënshtruar debateve publike dhe procedurave të rregullta të hartimit. Në atë kohë, është shpallur në interes publik homologimi. Aty është thënë se duhet të autorizohet një subjekt. Pra, jo kush është subjekti, siç këtu thanë disa deputetë, dhe përmendën emra të subjekteve në fjalë. Dhe kjo tregon se këtu nuk ka pasur monopol. Por, megjithatë pavarësisht kësaj, Nisma nuk është për monopol, në asnjë mënyrë. Duhet të ketë qendra të tjera, në qytete të tjera dhe normalisht të ketë edhe kompani të tjera të cilat veprojnë në këtë fushë.

Atëbotë ishte parashikuar si shërbim homologimi i automjeteve që importohen në Kosovë, apo përshtatshmëria teknike e automjeteve. Ishte përcaktuar në Ligjin për trafik rrugor. Po ashtu këto dispozita ishin akceptuar praktikisht më të mira për shërbimin e homologimit, përcaktuar me rregulloret, standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian. Këtë kornizë ligjore e kishte hartuar qeveria e atëhershme LDK-AAK, pra para vitit 2008. Pastaj Departamenti i Automjeteve dhe ekspertët e fushës, së bashku nën monitorim të ekspertëve ndërkombëtarë, ishte hartuar ky udhëzim administrativ. Ndërkohë që kishte filluar shërbimi në listën e shumë reformave të asaj kohe në fushën e kontrollit të automjeteve.

Homologimi ishte dhe mbetet praktikë e shteteve të Bashkimit Evropian dhe të regjionit, ku disa shtete u delegojnë subjekteve private, kurse disa shtete i kryejnë brenda institucioneve shtetërore. Në atë kohë, sipas raportimeve të kohës, kishte edhe një kërkesë nga një palë në Gjykatën Kushtetuese, e cila ishte shpallur si e papranueshme. Pra, ky proces dhe shërbim ishte trajtuar në instancën më të lartë të gjyqimit. Po të kishte elemente të pranueshmërisë, se bëhet fjalë për monopol, besoj se Gjykata do të nxirrte vendim dhe do të obligonte Ministrinë ta ndërpriste këtë praktikë. Kjo ishte sa për t'i shërbyer me informacion kolegët deputetë, disa nga ta, të cilët shpifën dhe mashtruan qytetarët me informacione të ndryshme, të cilat fare nuk janë të vërteta. Këtu po të jesh modest, këtu keqkuptohesh, sepse dikush modestinë e kupton sikur humbje debati. Këtu edhe edukata keqkuptohet. Po të jesh i edukuar, këtu mendojnë këta shpifës se nuk ke çka të thuash. Po të mos ua kthesh në të njëjtën formë këtyre shpifësve, këta mendojnë se e kanë mirë. Prandaj, duhet t'ua kthejmë ndonjëherë, ta heqim edhe ne atë petkun e një deputeti intelektual dhe t'i përgjigjemi në të njëjtën formë, sepse çdo ditë këta shpifës, këta mashtrues janë të tillë, dhe nëse nuk kanë mundur as kolegët e tyre t'i durojnë, pse t'i durojmë ne. Janë 12 shokë të tyre, madje më të mirët që tashmë nuk janë me ta, sepse ata tash e kanë kuptuar kush janë. Prandaj, të mos etiketojmë, të mos i quajmë ata të cilët kanë bërë për këtë vend, në forma dhe emra të ndryshëm.

Ndërsa, sa i përket asaj që tha, një shpifës tjetër aty në atë grup, që përmendi dialogun. Ne e dimë kur diçka i pengon Vuçiqit dhe Brnabiqit, pra kur i pengon Limaj atyre, pra, ekziston një linjë, fillona atje në Beograd e vazhdon këtu me disa shpifës dhe mashtrues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Këtu ka deputetë, kolegë tanët që të gjithë. A është e nevojshme? Glauk Konjufca, dy minuta!

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që në këtë seancë, kryesisht është folur me argumente. Të thuash që, faktikisht Eruolabi dhe homologimi dhe mënyra sesi i është dhënë “Euro-Labit” dhe Devollëve homologimi nuk është monopol, kjo e redukton këtë seancë në ata të cilët u panë qartë që janë kundër këtij manipulimi, edhe një grupi të cilët do t’i kisha quajtur apologjetët e Fatmir Limajt. Pra, vetëm dy grupe i pash sot në Parlamentin e Kosovës. Bile, edhe qëndrimi i Partisë Demokratike mesa e kuptova, është që ndryshohet kjo punë, se me të vërtetë është e tepër. Por, i vetmi grup që ka mbetur, që mund të quhen në njëfarë mënyre ‘oda e avokatëve’ të Fatmir Limajt, po e vazhdojnë të njëjtin avaz, këtu në seancë.

Unë mendoj që sa i përket këtij homologimit për të cilin u dhanë shumë argumente, këtu është krijuar një shumicë kritike në Kuvend të Kosovës dhe unë e përsërisht këtë fakt që kësaj t’i jepet fund. Tash më duket që këta që e mbrojnë Fatmir Limajn, janë të frikësuar se nëse vërtetohet që kjo ka qenë faktikisht monopol, atëherë do të shkohet me një fazë të mëtutjeshme. Prokuroria mund të nxisë këtu hetime. Faktikisht, a duhet dhënë tash përgjegjësi për të gjitha ato miliona që i kanë shkuar një xhepi privat? Kush ka përfituar prej atyre milionave? Këta frikësohen që nëse shkon puna deri aty, e humbin idolin e tyre dhe udhëheqësin e tyre, të cilin po e mbrojnë dëshpërimisht në këtë seancë. Po unë mendoj që kjo seancë është përtej kësaj mbrojtjeje.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi, replikë, dy minuta.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Glauku vazhdon me logjikën e propaganduesit. Logjikën tash ia shtroi vetes edhe shpifësin. Sepse nuk merr për bazë atë që e thash unë. Pra unë flas në emër të grupit të Nismës, jo Glauku. Unë thashë që e mbështesim heqjen e kësaj mënyre të dhënies së kontratës, sepse konsiderojmë që për ato dhjetë vjet sa ka qenë e bazuar në ligjet e kohës dhe të kërkosh tash armiq te ata që ta mbështesin, është të mos duash ta kalosh atë. Ndërsa, sa i përket frikës nga Prokuroria, ti veç ëndërr me pas kapërcyer nëpër ato shpifje, nëpër ato procese shpifëse, nëpër ato procese me insinuata, me lloj-lloj të pavërtetash, tash kishe qenë në çmendinë. Se aq e ke pikën e shkrirjes ti.

Pra, ai i ka fituar të gjitha betejat me ligj, përmes ligjit, askush s’ia ka falur ato, përkundër tendencave të vazhdueshme për ta linçuar. Edhe kjo tendenca juaj tash për ta rikthyer, ju bën apologjetë të shpifësve, apologjetë të atyre që e duan Fatmirin gjithsesi jashtë politikës, pa le të

jetë për çfarëdo arsye le të jetë. S'ka rëndësi a janë të vërteta, a s'janë të vërteta, rëndësi ka që ai të mos jetë aty se po na pengon, s'po na lë t'i realizojmë qëllimet e tona politike, apo ku ta di unë çfarë të tjera. Pra, qëndroni bre, rrini një herë korrektë, se për besë nëse vazhdoni me këtë logjikë, në karriget e mesme s'ka për t'u rënë të uleni kurrë. Ose keni për të dalë djathtas, ose majtas.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radhën e ka deputetja Fitore Pacolli-Dalipi.

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Nga dje kemi parë që PSD-ja po e mbron Nismën, Nisma PSD-në, po s'kanë çka të bëjnë të shkretët se Gjykata Kushtetuese u ka treguar vendin ku e kanë, dhe këta vazhdojnë ta mbrojnë njëri-tjetrin se kaq u ka mbetur. Tregu i lirë është një nga kriteret themelore të Bashkimit Evropian, kurse ne kemi dy dekada që partitë politike në pushtet, i dëgjojmë të na flasin për treg të lirë në emër të tregut të lirë, në këtë vend është shitur tërë pasuria publike e shtetit të Kosovës. Në emër të tregut të lirë, në këtë vend, pas çdo shitjeje, këto parti politike janë pasuruar. Pra, kanë ndarë një përqindje të madhe të fitimit për vete.

Qeveria herë flet për integritet evropian, po me veprimet e tyre bie në kundërshtim me vlerat dhe parimet e Bashkimit Evropian. Pra, në njërin anë thotë, se kemi qëllim dhe parim integritet evropian, në anën tjetër veprimet dhe puna e tyre nuk përputhet askund me atë thonë.

Ditëve të fundit, siç e keni parë, PAN-i është munduar që me të gjitha mjetet që kishin nën kontroll t'i bindnin qytetarët se kinse Bashkimi Evropian, raporti i ekspertëve të TAIX-it, kishte thënë se nuk ka monopol.

Ndërkaq kur e panë se nuk iu eci dhe kur e panë se për t'ju shitur këto politika të cilat i shtyjnë duhet të përdorin një strategji pak më ndryshe, këtu në Kuvend sot, të gjithë e pranuan se ka monopol. Pra, e demantuan vetën dhe e demantuan Qeverinë dhe ministrin.

Para dy ditëve, sipas tyre nuk kishte monopol, dhe sipas tyre kështu thoshte edhe Bashkimi Evropian. Ndërkaq, sot një numër i madh i deputetëve të PAN-it e cituan raportin e Bashkimit Evropian dhe raportin e ekspertëve të TAIX-it.

Ashtu siç e theksuan shumë deputetë këtu, raporti i Bashkimit Evropian për vendin dhe ekspertëve të TAIX-it, ka konfirmuar se ka monopol dhe ka rekomanduar që të ndërmerren masat e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur.

Raporti për vendin thotë se, në Kosovë ekzistojnë monopole të një natyre tregtare, në kuptim të nenit 37 të Traktit për Funkcionim e Bashkimit Evropian, dhe se marrëveshja ekskluzive me një kompani private lidhur me homologimin e detyrueshëm të automjeteve për të gjitha makinat e importuara ngre shqetësime serioze.

Raporti i TAIX-it, raport ky i ekspertëve evropianë të angazhuar specifikisht për këtë çështje thotë se, definimi i legjislacionit të Kosovës, pra Ligji për automjete, është në shpërputhje me legjislacionin e BE-së dhe krijon një shpronësim të tregut të brendshëm.

Edhe ambasadorët relevantë të shteteve të BE-së e kanë thënë të njëjtën gjë. Po ashtu, njëjtë e ka thënë edhe përfaqësuesja e Bashkimit Evropian, e cila e tha qartë dhe shkoqitur se ky është një monopol dhe se nëse Pal Lekaj nuk ndalet, me një fjalë Kosova do të ketë monopol edhe për 10 vite të tjera dhe se Kosova duhet ta ndryshojë këtë situatë.

Pra, deri këtu, njëjtë sikurse Bashkimi Evropian, njëjtë sikurse shtetet; Britania, Gjermania, ambasadorët e shteteve si Britania, Gjermania dhe të tjera edhe këtu u pajtuam se, po ka monopol. Të gjithë u pajtuam. Shumë mirë.

Deputetët e PAN-it, tani pranuan dhe u pajtuam se nëpërmjet homologimit, prej vitit 2008, janë vjedhur qytetarët e këtij vendi dhe se kjo vjedhje po vazhdon edhe sot dhe se ka nevojë që të bëhen ndryshime. Shumë mirë, po pajtohemi të gjithë.

Atëherë, pse s'po bëhemi ne deputetët, tamam siç ju ka hije, deputetë të popullit e ti japim fund hajnisë. E fundi hajnisë i vjen veç duke e rrëzuar këtë Qeveri. Edhe ashtu, qëndrimet tuaja nuk po përkojnë më me ato të Qeverisë. Qëndrimet tuaja po janë ndryshe me qëndrimet e Qeverisë dhe të ministrit Lekaj.

Ju po shpreheni kundër monopolit dhe kundër vjedhjes, ministri Lekaj po insiston që ta mbajë këtë vjedhje. Pra, po insiston që të vazhdohet vjedhja që po bëhet prej një kompanie private.

Atëherë, ju si deputetë kishit dallime edhe për sa i përket Ligjit për sponsorizime apo jo? Pra, kishit dallime me Qeverinë. Kjo i bie se ju nuk pajtoheni më me Qeverinë, prandaj që duhet të bëhemi bashkë dhe ta rrëzojmë Qeverinë. T'i japim fund hajnisë së kësaj Qeverie. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demalijaj,

**SHKUMBIN DEMALIJAJ:** I nderuar nënkryetar, faleminderit!

Ndoshta fillimi i fjalisë sime ishte paksa i vobektë për këtë falënderimin, se duke dëgjuar fjalime të formatit melankolik ose të monologut, ishte duke me marrë gjumi.

Duke u mundur që ta bëj një përzgjedhje. Duke i specifikuar disa fjalime në formë fabulash dhe duke folur tjerë më shumë. Është i mirë debati. Unë e kuptoj këtë debat pak më ndryshe se sa ata që e kanë nisur. Këtu, përgjegjësia dhe autopërgjegjësia po dihet sesi është.

Ne jemi këtu që të prodhojmë ligje. Ky Kuvend dhe asnjë Kuvend tjetër as në formë të dhunshme, po me votë ka nxjerrë atë ligji, i cili është deri më tash edhe është në zbatim.

Më vjen mirë për Glaukun nëse ka vendosur që të marrë një preventiv, që të dihet se pas gjysmës së korrikut, veç i skadon kontrata me ligj kësaj kompanie që flitet për monopol. Edhe si masë preventive, nëse duam, deputetët e Kuvendit janë këtu, iniciativa mund të lind dhe të rregullohet.

Për disa të tjerë në formë monologuese, duku u mundur shkarazi kinse po ndërmjetësojmë ndërmjet koalicionit kush po i beson edhe kush s'po i beson Qeverisë. E them kushtimisht se aq të vegjël janë edhe aq të vockël në formë fabule, sa që mua më vjen mirë edhe besoj se ndjehem mirë që këta me të vërtetë jetojnë në kohën e Pal Lekajt.

S'po them për 30-40 deputetë tjerë me merita shumë të veçanta, po për këta deputetët e vockël që ishin duke na vënë në gjumë me fabula, edhe njëherë po ju them se me vjen mirë që jetojnë në kohën e Pal Lekajt.

M'i thënë dikujt hajn, e ka rrugë shumë, procese gjyqësore, me të vërtetë këta njerëz është duke i penguar diçka, ardhja në pushtet për të vjedhur. Mendjen e kishin që sa më shumë që flasin dhe asnjëherë nuk drejtohen te mekanizmat përgjegjës nëse dikush është duke vjedhur.

Drejtojuni institucioneve që i kryejnë këto punë dhe mos na flisni, se atëherë shumë po kemi frikë se nëse ndonjë ditë do të vini pushtet, do të vini vetëm sa për të vjedhur. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kjo ka qenë një prej seancave me komunikimet më të çuditshme që i mbaj në mend. Glauk Konjufca, dy minuta replikë.

**GLAUK KONJUFCA:** Unë mendoj që t'i ndash deputetët në deputetë të mëdhenj dhe deputetë të vockël, nuk është fare korrekte nga një koleg deputet i yni këtu në Kuvendin e Kosovës.

E dyta, këto që i prezantuam ne, sidomos ajo që unë e thashë në fillim sa i përket Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe atyre argumenteve të tyre profesionale, aty nuk mund të themi se janë shpifje, akuza me interesa partiake, sepse disa prej tyre janë edhe shokë të Shkumbinit dhe ia kanë thënë edhe këtij të njëjta që m'i kanë thënë mua.



Por, ky për shembull, nuk e shtron argumentin prej atij dimensionit, dhe krejt reduktohet aty, sepse e ka në parti Pal Lekajn. Halli im është sesi ne të dalim përtej kësaj. Që ky i di të njëjtat, ato argumente që i thashë unë, sepse i ka dëgjuar prej njerëzve të njëjtë.

Argumente e njëjta që ia kanë shkruar ministrin me letër që është monopol, të lutem mos e bë udhëzimin administrativ. Ia kanë shkruar 20 faqe me vërejtje, se ku duhet të ndryshohet, se nuk janë ato në rregull edhe që janë në kundërshtim me ligjet e Kosovës. Se këtu tekefundit po dëmtohet qytetari me çmime.

Sa po paguajmë ne për një veturë, se s'po mund ta regjistrojnë veturën.

Tash, më vjen keq që Shkumbini i di këto edhe e devijon temën prej një drejtimi tjetër. Domethënë, e akuzon Vetëvendosjen, i ndanë deputetët në të vegjël dhe të mëdhenj. Me të vërtetë nuk është në rregull. E ftoj t'i kthehet argumenteve.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Shkumbin Demaliaj, kundër-replikë.

**SHKUMBIN DEMALIAJ:** Është e vërtetë për atë që po thotë Glauku, se unë i kam takuar këto grupe të interesit, dhe këta e kanë kryer afatgjatë atë punë aty.

Por, Glauku ka harruar se në kuadër të organizatave buxhetore, ka menduar që Ministria e Arsimit tua ndërtojë edhe një institut në ambientet universitare këtij mekanizmi. Mirëpo, kur këto gjëra kalojnë nga praktika në element politik dhe dikush mendon që të përfitojë politikisht duke e ofenduar dikë që është që një vit e gjysmë në Qeveri, e kjo prej 2009-ës vazhdon të jetë kështu, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, unë mendoj që është e tepërt.

Nuk i iki asnjë formë të debatit dhe të realitetit. E thashë, e thanë edhe kolegët e mi të grupit, po e thanë të gjitha subjektet politike këtu; hajde të hyjmë plotësim-ndryshimit të ligjit.

Glauk, do të jem i pari që ta jep nënshkrimin nëse dëshiron që ta marrësh këtë iniciativë. I hyjmë pastaj plotësim-ndryshimeve edhe shkojmë vazhdojmë dhe jo vetëm të flasim...

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi s'është në sallë. Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi. Po e tërheq? Në rregull. Faleminderit!

Atëherë, nuk ka kolegë të tjerë të paraqitur për fjalë. Unë e ftoj iniciuesin e kësaj seance për fjalën përfundimtare dhe për rekomandimet meqë mocion përmbajtjesor me shkrim, iniciuesi nuk ka dorëzuar paraprakisht.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kolegë të nderuar,

Në fund, pa dashur që të hyjë në çështjet që bënë që degradoi debati në formë të ndryshme. Më lejoni që veç shkurt që disa pyetje që u ngritën nga disa prej kolegëve.

Së pari sa i përket ligjit, po e ceku edhe njëherë se ligji është në plotni, në realitet licenca apo çfarëdo marrëveshje që ka mundur t'ia vazhdojë homologimin, monopolin aktual, nuk ka të bëjë me ligj, për shkak se ligji nuk i parasheh ato.

Raporti i TAIX-it i përmend vetëm dy pika, është neni 10, që janë procedurat për plotësim të kushteve për lëshimin e mjeteve në treg dhe neni 19, që janë obligimet e prodhuesve.

Nuk ka nen më të mirë sesa neni 10.2 që e thotë, procedurën për homologimin e mjeteve e kryejnë subjektet e autorizuara. Pra, çfarëdo gjë tjetër që flitet në lidhje me ligjin është e kotë.

Neni 34.2 që u përmend, Ahmetin nuk e kemi këtu, flet për licencë. Pra, çdokush që i plotëson kushtet i vazhdohet licenca në afat të pacaktuar, por nuk flet as për marrëveshje as për kontrata të monopolit.

Mosprishja e njëanshme e marrëveshjes, për kolegun tim Memlin, janë të gjitha përgjigjet, raportet zyrtare të shkruara brenda ministrisë po edhe jashtë ministrisë që nuk duhet të hyjnë në prishje të një anshme të asaj marrëveshjeje.

E kemi pasur një tentativë në Qeveri, po besoj që Memli e di, që s'kemi mundur ta kalojmë. Kështu që ajo është provuar, nuk ka mundur të kalojë dhe të gjitha raportet tjera zyrtare të brendshme e të jashtme na kanë sugjeruar që ai është një gabim nëse e bën Qeveria.

Derisa askush nuk ka dhënë kurrfarë propozimi, unë prapë po e paraqes vendimin që duhet ta marrë Kuvendi.

1. Menjëherë të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ 2/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore i Ministrisë së Infrastrukturës.

2. Në afat prej dy muajsh të miratohet udhëzimi i ri administrativ i cili duhet të jetë në përputhje me Ligjin për automjete, Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe natyrisht rekomandimet e Zyrës së BE-së në Kosovë në përputhje, ashtu siç e tha edhe kolegu Nitaj, që ato rekomandime duke qenë se janë në përputhje me ligjet.

3. Po e shoh që ka paksa dyshime, ne nuk kemi kurrfarë problemi që të shtohet urgjent që të ndërmerren masa për ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme legjislative që të eliminohen monopolet. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani... Jo, pas fjalës së iniciuesit, fjalës përfundimtare s'keni të drejtë. Ju e dini të gjithë. Kështu që, meqë nuk kemi kuorum që të votojmë, dhe s'keni kërkuar harmonizim të tekstit ose diçka të ngjashme, unë jam i detyruar që ta ndërpres seancën. Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*